

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8304  
E mërkurë, 20 maj 2026  
Çmimi 0.50 €

Shkurte Fejza takon ish-presidentin Clinton: Mirënjohje nga zemra në emër të popullit të Kosovës | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## FSK-ja DREJT USHTRISË, POR PA SPITAL USHTARAK

FAQE 4-5



FSK-ja është drejt transformimit në ushtri me kapacitete të plota, por ende nuk ka spital ushtarak funksional. Trajtimi mjekësor i

pjesëtarëve të saj kryhet brenda kazermave ose në spitale civile publike e private për rastet më serioze. Ekspertët

paralajmërojnë se mungesa e një strukture spitalore ushtarake mbetet boshllëk në zhvillimin e ushtrisë së re

### AKTUALE



TRUMPI PEZULLON SULMIN E PLANIFIKUAR NDAJ IRANIT, NEGOCIATAT VAZHDOJNË | F. 2

KURTI: KOSOVËS I DUHET PRESIDENT KONSENSUAL | F. 3

FSHAT OLIMPIK E SPITAL MODERN: MOSKOORDINIM E PAQARTËSI PËR INVESTIME MADHORE NË PRISHTINË | F. 6

### EKONOMI



REFORMA SOCIALE, ZHVILLIMI NJERËZOR DHE POLITIKAT E PUNËS, TEMË DISKUTIMI MES HOTIT DHE BB-së | F. 8

GAP-i: KOMUNAT PAGUAN 126.6 MILIONË EURO VITIN E KALUAR PËR VENDIME GJYQËSORE DHE PËRMBARIMORE | F. 8

### SPORT



SHKON SILVINJO VJEN ROLANDO MARANI NË KRYE TË KOMBËTARES SË SHQIPËRISË | F. 24



OVLUÇK-ja DËNON SULMËT NDAJ HARADINAJT E LUSHTAKUT: S'ËSHTË E RASTËSISHME, KURTI TA NDAJË FUSHATËN ANTIÇLIRIMTARE | F. 3

D4D PUBLIKON ANALIZËN GJINORE TË ZGJEDHJEVE 2025, KËRKOHEM MË SHUMË PËRFAQËSIM I GRAVE NË POLITIKË | F. 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030-500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## TRUMPI PEZULLON SULMIN E PLANIFIKUAR NDAJ IRANIT, NEGOCIATAT VAZHDOJNË

UASHINGTON, 19 MAJ - Presidenti amerikan Donald Trump tha se ka pezulluar një sulm të planifikuar ajror ndaj Iranit për të lejuar zhvillimin e negociatave për t'i dhënë fund konfliktit në Lindjen e Mesme, pasi Teherani dorëzoi një propozim të ri për paqe përmes Pakistanit, që ka rolin e ndërmjetësuesit. Trumpi shkroi në rrjetet sociale mbrëmjen e 18 majit se i ka thënë ushtrisë që "ne nuk do ta realizojmë sulmin e planifikuar për nesër ndaj Iranit, por kam dhënë instruksione të reja që të përgatitet për një sulm të plotë në shkallë të gjerë ndaj Iranit, në çdo moment, në rast se nuk

arrihet një marrëveshje e pranueshme". I përballur me presion për ta rihapur Ngushticën e Hormuzit dhe për ta reduktuar ndikimin ekonomik të luftës, Trumpi tha se udhëheqësit e Katarit, Arabisë Saudite dhe Emirateve të Bashkuara Arabe i kanë bërë thirrje atij që ta ndërpresë sulmin sepse "një marrëveshje do të arrihet". Irani ka konfirmuar se qëndrimet e tij i janë dërguar Uashingtonit përmes Pakistanit, edhe pse një burim pakistanez paralajmëroi: "Nuk kemi shumë kohë". Duke folur për gazetaret disa orë pasi njoftoi për shtyrjen e



sulmit ushtarak të planifikuar për të martën, Trumpi tha se Shtetet e Bashkuara do të ishin të kënaqura vetëm nëse arrihet një marrëveshje me Iranin që parandalon Teheranin që të ketë

armë bërthamore. Udhëheqësi amerikan shtoi se "duket se ka një shans të mirë që të punohet për një marrëveshje", teksa Pakistani i përshkroi bisedimet si "të vështira".

Propozimi i Iranit raportohet se vë si prioritet përfundimin e konfliktit që nisi në fund të shkurtit, rihapjen e Ngushticës së Hormuzit, përmes së cilës para luftës kalonte rreth një e pesta e furnizimeve globale me naftë dhe gaz, dhe lehtësimin e sanksioneve, teksa, po ashtu, shtyn zgjidhjen e mospajtimeve lidhur me programin bërthamor të Teheranit. Burimet iraniane kanë pretenduar se Uashingtoni ka treguar fleksibilitet më të madh sa iu përket aseteve të ngrira dhe aktivitetit civil bërthamor, edhe pse ShBA-ja nuk ka konfirmuar se ka bërë ndonjë lëshim.

## EUROPOL SHËNJESTRON PROPAGANDËN ONLINE TË GARDËS REVOLUCIONARE TË IRANIT

HAGË, 19 MAJ - Agjencia për zbatim të ligjit e Bashkimit Evropian ka shënjestruar propagandën online të Korpusit të Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC) në një operacion të koordinuar kundër përmbytjes terroriste online. IRGC-ja është shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, BE-ja, dhe vende të tjera, përfshirë edhe Kosova. Agjencia evropiane policore, EUROPOL, njoftoi se në këtë operacion janë shënjestruar 14 200 postime të lidhura me Gardën Revolucionare. Aksioni u përqendrua në identifikimin dhe pengimin e pranisë online të grupit, që "përdorej për të përhapur propagandë, për të rekrutuar mbështetës dhe për të mbledhur fonde", u tha në njoftim. EUROPOL tha se 19 shtete bashkuan forcat për të identifikuar dhe ndërprerë përmbytjen e lidhur me



Gardën iraniane në internet: Austria, Belgjika, Bosnjë e Hercegovina, Bullgaria, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Italia, Holanda, Portugalia, Spanja, Suedia, Ukraina dhe Shtetet e Bashkuara. Nga 13 shkurti deri më 28 prill autoritetet nga këto shtete punuan së bashku, nën koordinimin e EUROPOL-it,

duke mbledhur të dhëna, duke verifikuar caqet dhe duke verifikuar platforma online. Sipas agjencisë së BE-së, përmbytja u shpërnda në platformat kryesore të medieve sociale si dhe në shërbime të transmetimit online, në faqe të blogjeve e uebfaqe të pavarura. Përmbytja propaganduese, sipas EUROPOL-it, u identifikua në disa gjuhë, përfshirë arabisht, anglisht, frëngjisht,

persisht e spanjisht. Përmbytja ishte në formate të ndryshme, sikurse fjalime që kishin narrativë fetare të martizimit të ndërthurura me mesazhe politike e deri te video të gjeneruara me inteligjencë artificiale që lavdëronin Gardën Revolucionare Islamike dhe bënin thirrje për hakmarrje për vrasjen e liderit suprem iranian, Ali Khamenei. Khameni u vra gjatë sulmeve ajrore në nisje të luftës së ShBA-së dhe Izraelit kundër Iranit më 28 shkurt. EUROPOL tha se ndërlihdja e faqeve të internetit të lidhura me Gardën, që operonin në shumë gjuhë, ofron informacione të rëndësishme se si funksionon ky grup online. Pasi u identifikuan mbi 14 000 postime të lidhura me Gardën – e cila në X ka 150 000 ndjekës – llogaria e Gardës në këtë platformë u bllokua nga BE-ja, ndërkaq linqe të tjera, të lidhura me disa platforma ose janë

hequr ose po hetohen, tha EUROPOL. Ky operacion gjeti se Garda iraniane vazhdon ta zgjerojë praninë e saj digjitale. Hetuesit gjetën se ajo ka rrjete online në shumë vende, duke nisur nga Rusia e ShBA-ja, që i mundësojnë të ketë prani në internet. Autoritetet, po ashtu, identifikuan transaksione që janë kryer duke përdorur kriptovaluta me qëllim amplifikimin e operacione online, një taktikë që, sipas EUROPOL-it, është e dizajnuar për t'i shmangur kontrollat tradicionale financuese. Korpusi i Gardës Revolucionare Islamike të Iranit është krahu ideologjik i ushtrisë së Teheranit dhe u krijua pas revolucionit të vitit 1979 për ta mbrojtur udhëheqjen klerikale. Garda kontrollon ose zotëron kompani në gjithë ekonominë iraniane, përfshirë sektorë strategjikë kryesorë.

## Shembet një ndërtesë në Gjermani, ekipet e shpëtimit kërkojnë të mbijetuar

GÖRLITZ, 19 MAJ - Ekipet e shpëtimit kanë vazhduar të martën në mëngjes kërkimet për tre persona të zhdukur, pasi një ndërtesë u shemb të hënën në mbrëmje në qytetin gjerman Görlitz, pranë kufirit me Poloninë. Policia ka bërë me dije se shkak i mundshëm i shembjes mund të ketë qenë një shpërthim gazi. Për shkak të rrezikut nga rrjedhjet e gazit, ekipet në terren po veprojnë me kujdes të madh gjatë kontrollit të rrënojave dhe sigurimit të zonës.

Pasi tentimet për të gjetur të zhdukurit me ndihmën e genve kërkues nuk dhanë rezultat, ekipet e shpëtimit nisën largimin e rrënojave me ekskavatorë dhe me mjete dore. Frika fillestare se deri në pesë persona mund të kishin mbetur nën rrënoja më vonë rezultoi e pasaktë, tha policia. Një burrë, i cili druante se gruaja dhe kushërira e tij kishin mbetur të bllokuara nën rrënoja, tregoi se ato kishin ardhur atë ditë për pushime në një shtëpi të marrë me qira. Ai tha se, ndërsa

ndodhej në një supermarket aty pranë, dëgjoji një shpërthim të fuqishëm e kur u kthye pa vetëm një grumbull të madh rrënojash. Sipas policisë, ndërtesa e shembur ishte ndërtuar në stilin historik vilhelminian dhe përbante apartamente banimi me qira si dhe apartamente për turistë. Görlitz është qyteti më i lindor i Gjermanisë dhe ka rreth 57 mijë banorë. Qendra e tij historike e ruajtur mirë përdoret shpesh si lokacion për produksione ndërkombëtare filmike.



## Haradinaj pret në takim ambasadorin Hargreaves, diskutojnë për anëtarësimin e Kosovës në NATO

PRISHTINË, 19 MAJ - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka pritur në takim ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuara në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Haradinaj, përmes një postimi në profilin e tij në rrjetin social "Facebook", ka shkruar se Kosova vlerëson lart marrëdhëniet e shkëlqyera me Mbretërinë e Bashkuar dhe mbështetjen e vazhdueshme për forcimin e

subjektivitetit tonë shtetëror në arenën ndërkombëtare. "Me ambasadorin Jonathan Hargreaves, biseduam për proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë dhe për avancimin e marrëdhënieve bilaterale ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës së Kosovës. Ambasadorin Hargreaves e falënderova për angazhimin e tij dhe të Mbretërisë së Bashkuar në mbështetje të

Republikës së Kosovës. Kosova vlerëson lart marrëdhëniet e shkëlqyera me Mbretërinë e Bashkuar dhe mbështetjen e vazhdueshme për forcimin e subjektivitetit tonë shtetëror në arenën ndërkombëtare. Në këtë drejtim, anëtarësimi i Kosovës në NATO mbetet një domosdoshmëri strategjike për paqen, sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë në rajon", ka shkruar Haradinaj.



## "DAUT RADOIÇIQI", OVLUÇK-JA DËNON SULMET NDAJ HARADINAJT E LUSHTAKUT: S'ËSHTË E RASTËSISHME, KURTI TA NDALË FUSHATËN ANTIÇLIRIMTARE

PRISHTINË, 19 MAJ - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së i ka quajtur "sulme të ndyra" disa deklarata në drejtim të ish-komandantëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Daut Haradinaj dhe Sami Lushtaku. "Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së dënon sulmet e ndyra të drejtuara kundër gjeneralëve të Luftës Çlirimtare, sulme që tani po përforcohen nga qarqe, prejardhja politike dhe familjare e të cilave u kalit në shërbim besnik ndaj Jugosllavisë dhe pushtimit serb", thuhet në reagimin e OVLUÇK-së.

Organizata e Veteranëve tha se "asnjë shpifje nuk mund ta njollosë luftën që çliroi Kosovën". "Gjeneralët dhe

luftëtarët e UÇK-së nuk u kërkuar kurrë leje puthadorëve të një regjimi të vdekur para se të rroknin armët për këtë tokë. Sakrifika e tyre është themeli mbi të cilin ngrihet Kosova. Ata që pështynë mbi të, nuk shpërfaqin asgjë tjetër veçse zbrazëtinë e tyre politike dhe kalbëzimin moral", thuhet në reagim.

OVLUÇK-ja thotë se "nuk është e rastësishme" kjo gjuhë "kundër UÇK-së". "Pas dy vitesh krizë institucionale, nxitja e qëllimshme e militantëve kundër UÇK-së nuk është e rastësishme. Është një lëvizje e llogaritur për të helmuar jetën publike, për të përçarë shoqërinë shqiptare dhe për ta çuar Kosovën drejt



përplasjes së brendshme. Interesit të kujt i shërben kjo sjellje? Qartazi, Serbisë, në fushatën e saj të gjatë për të kriminalizuar Luftën Çlirimtare dhe për të shkatërruar unitetin tonë

kombëtar". Kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, i është kërkuar që ta ndalë "nxitjen e këtyre sulmeve". "Albin Kurti dhe Vetëvendosje duhet të ndalin, tani, nxitjen e këtyre sulmeve

ndaj UÇK-së, veteranëve dhe komandantëve të saj. Kosova nuk u çliroi që aventurierët politikë të përdorin si armë konfliktin qytetar për pushtet. Ata që nuk trashëgjuan asgjë nga kjo përpjekje, nuk kanë asnjë tagër të gjykojnë ata që e ngritën atë me gjak. Kërkojmë llogaridhënie publike dhe ndërprerje të pakushtëzuar të kësaj fushate antiçlirimtare. Vazhdoni në këtë rrugë dhe pasojat do të jenë të përhershme", thuhet në reagim.

OVLUÇK-ja mori shkas nga disa deklarata të rënda dhe kërcënuese së fundmi të një mërgimtari të quajtur Naser Xhyllani ndaj Daut Haradinajt, të cilin e quajti "Daut Radoiçiqi".

## JASHARI PRITI GJENERALIN AMERIKAN: SË SHPEJTI PRITET DISLOKIMI I KONTINGJENTIT TË PARË TË FSK-së NË GAZA



PRISHTINË, 19 MAJ - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Bashkim Jashari, ka pritur në takim zëvendëshefin e J5/8 të Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara (USEUCOM J5/8), gjeneralbrigade Chris A. McKinney.

Fillimisht të dy gjeneralët diskutuan për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Komandës Evropiane të Shteteve të Bashkuara si dhe nevojën për rritjen e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Pastaj gjeneral Jashari e njoftoi gjeneralin McKinney për zhvillimet dhe të arriturat e FSK-

së duke u fokusuar edhe në planet për të ardhmen që synojnë realizimin e aspiratave për anëtarësim në NATO.

Gjithashtu, të dy gjeneralët vlerësuan kontributin e FSK-së në kuadër të Forcës Ndërkombëtare Stabilizuese për Gazën (ISF), ku së shpejti pritet të disloket kontingjenti i parë nga FSK-ja.

Në fund të takimit gjeneral McKinney falënderoi gjeneral Jasharin për bashkëpunimin dhe lidhshërinë e tij gjatë kësaj kohe ku FSK është në fazën finale të PGJT-së si dhe ritheksoi përkushtimin e USEUCOM-it për ta mbështetur FSK-në në të ardhmen.

## Kurti: Kosovës i duhet president konsensual

PRISHTINË, 19 MAJ - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka deklaruar se pas zgjedhjeve të

jashhtëzakonshme të 7 qershorit, vendit i duhet një president konsensual. I pyetur nëse do të nevojitet

kompromis për zgjedhjen e presidentit apo presidentes së ardhshme, Kurti u përgjigje shkurt duke thënë

se duhet president konsensual. "Duhet president konsensual", ka thënë Kurti.





## FSK-ja DREJT USHTRISË, POR PA SPITAL USHTARAK

FSK-ja është drejt transformimit në ushtri me kapacitete të plota, por ende nuk ka spital ushtarak funksional. Trajtimi mjekësor i pjesëtarëve të saj kryhet brenda kazermave ose në spitale civile publike e private për rastet më serioze. Ekspertët paralajmërojnë se mungesa e një strukture spitalore ushtarake mbetet boshllëk në zhvillimin e ushtrisë së re

**PRISHTINË, 19 MAJ** - Ndërsa Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) po i afrohet fazës përfundimtare të transformimit në ushtri me kapacitete të plota, një boshllëk thelbësor vazhdon të mbetet: mungesa e një spitali ushtarak.

Dy vjet para përmbylljes së këtij procesi, pjesëtarët e FSK-së detyrohen ende të kërkojnë trajtim jashtë strukturave ushtarake për raste më serioze shëndetësore. “Kur kemi nevojë për trajtim më të avancuar, shkojmë në spitale publike ose private”, thotë për Radion Evropa e Lirë një pjesëtar i FSK-së, në kushte anonimiteti.

Ai shpjegon se ndihma e parë dhe shërbimet bazike ofrohen brenda kazermave, ndërsa Qendra e Mjekësisë në Kazermën “Adem Jashari” në Prishtinë mbetet struktura më e avancuar mjekësore brenda forcës. Megjithatë, për raste më serioze, opsionet janë të

kufizuara. “Mungesa e një spitali ushtarak është temë që diskutohet shpesh mes nesh, sidomos për raste afatgjata apo më të rënda”, shton ai.

### Kapacitetet në rritje, infrastruktura në ngecje

Transformimi i FSK-së në ushtri, i nisur në vitin 2018, parasheh që deri në vitin 2028 kjo forcë të ketë mbi 7 500 pjesëtarë, përfshirë 5 000 trupa aktive - një objektiv që, sipas Ministrisë së Mbrojtjes, tashmë është arritur. Ky transformim përfshin jo vetëm rritjen e numrit të ushtarëve, por edhe ngritjen e kapaciteteve të reja operative, si: armatim, trajnime dhe pjesëmarrje në misione ndërkombëtare. Por, ndërsa kapacitetet ushtarake rriten, infrastruktura mbështetëse duket se nuk ndjek të njëjtin ritëm.

Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci,

thotë shkurtimisht për Radion Evropa e Lirë se FSK-ja po zhvillon kapacitetet e saj mjekësore sipas modelit të sistemit mjekësor ushtarak amerikan, por nuk ofron më shumë detaje. “FSK-ja ka një qendër mjekësore, e cila ka kapacitete të ofrimit të shërbimeve të mjekësisë primare dhe disa shërbimeve specialiste”, thotë ai, duke shtuar se qendra ka edhe një hapësirë infrastrukturore për hospitalizim.

Për ish-komandantin e FSK-së, Kadri Kastrati, ndërtimi i një spitali ushtarak në këtë fazë të zhvillimit të forcës është i domosdoshëm. “Shteti duhet t’i avancojë shërbimet mjekësore, sikurse që i kanë vendet e rajonit dhe ato evropiane”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, Qendra Mjekësore në Kazermën “Adem Jashari” është ndërtuar pikërisht me idenë që në të ardhmen të shndërrohet në spital ushtarak.

Infrastruktura bazë ekziston, porse mungojnë investimet në personel dhe pajisje. “Kjo mund të realizohet nëse ekziston vullnet politik”, shton Kastrati për Radion Evropa e Lirë.

Eksperti i sigurisë, Ismet Ibishi, i cili ka shërbyer edhe si zëvendësministër i Punëve të Brendshme, thotë se spitali ushtarak është standard i një ushtrie

moderne. Sipas tij, prania e personelit mjekësor në operacione ushtarake është thelbësore jo vetëm për trajtimit, por edhe për rritjen e sigurisë dhe moralit të trupave. “Edhe në ushtrime ushtarë mund të lëndohen, aq më tepër në zona lufte”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

### Kapacitetet ekzistuese dhe sfidat teknike

Sipas ish-drejtorit të Qendrës Mjekësore të FSK-së, Shkëlzen Sylaj, objekti aktual në Kazermën “Adem Jashari” ka hapësirë dhe mundësi për rreth 60 shtretër, por mbetet i paplotësuar me pajisje moderne dhe staf të specializuar. Ai përmend nevojën për aparatura të ndryshme si rezonancë magnetike, CT skaner dhe laboratorë të avancuar, si dhe për staf të organizuar në shërbim 24-orësh. “Sistemi spitalor nënkupton shërbim 24 orë dhe për këtë duhen disa specialistë për secilin profil”, thotë Sylaj për Radion Evropa e Lirë. Ai shton se Kosova ka kuadro të mjaftueshme mjekësore - nga ortopedët, internistët, kardiologët e deri tek oftamologët - porse funksionalizimi i një spitali ushtarak kërkon kosto të lartë dhe strukturë të re organizative.

### Premtime pa afate dhe mungesë transparence

Ngritja e një institucioni të tillë është përmendur edhe në nivelin më të lartë shtetëror. Në dhjetor të vitit 2023, presidentja e atëhershme e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se ky projekt është pjesë e një programi shtetëror që parasheh shërbime shëndetësore deri në nivel terciar për ushtarakët, policët dhe familjet e tyre. Megjithatë, institucionet nuk kanë dhënë hollësi konkrete për afatet apo fazën e realizimit të projektit. Ndërkohë, në Strategjinë e Mbrojtjes 2023, ky projekt nuk përmendet fare.

Radio Evropa e Lirë kërkoi sqarime nga Zyra e Presidentes, Zyra e Kryeministrit, Ministria e Mbrojtjes dhe FSK-ja, por deri në publikimin e këtij artikulli nuk mori përgjigje. FSK-ja refuzoi edhe kërkesën për vizitë në Qendrën e Mjekësisë në Kazermën “Adem Jashari”, duke u arsyetuar me angazhime të planifikuara.

As Ministria e Shëndetësisë nuk dha përgjigje lidhur me kapacitetet e mundshme për mbështetje, në rast të funksionalizimit të një spitali ushtarak.

E në raportin vjetor të

# D4D PUBLIKON ANALIZËN GJINORE TË ZGJEDHJEVE 2025, KËRKOHEM MË SHUMË PËRFAQËSIM I GRAVE NË POLITIKË

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 MAJ - Të martën u lansua punimi "Analizë e rezultateve të zgjedhjeve lokale dhe nacionale 2025 nga perspektiva gjinore", në konferencën e organizuar nga Democracy for Development (D4D) dhe Qendra për Barazi dhe Drejtësi.

Gjatë konferencës u paraqitën gjetjet kryesore të raportit dhe u diskutua mbi sfidat e përfaqësimit të grave

në politikë, barrierat strukturore dhe nevojën për më shumë hapësirë e mbështetje për gratë në vendimmarrje. "Përderisa gratë po marrin pjesë aktivisht dhe në mënyrë konkurruese në proceset politike, barrierat strukturore ende pengojnë përfaqësimin e tyre të plotë dhe të barabartë në institucionet vendimmarrëse. Kuotat ligjore nuk mund të jenë destinacioni përfundimtar; ato janë pika hyrëse, jo pika

përfundimtare e barazisë", tha Ronald Goldberg, zëvendëseshë i Misionit në Embassy of the Netherlands in Kosovo. "Raporte të tilla u ofrojnë politikëbërësve, partive politike, institucioneve zgjedhore dhe organizatave të shoqërisë civile të dhënat e nevojshme për t'i identifikuar boshllëqet dhe për t'i ndërmarrë masat e nevojshme", shtoi Goldberg.

Në panelin "Nga kuota në përfaqësim të vërtetë: Fuqizimi i Grave në Politikë"

morën pjesë Arbëreshë Kryeziu-Hyseni (LV), Eliza Hoxha (PDK), Sibel Halimi (LDK) dhe Time Kadrijaj (AAK), kurse u moderuar nga Muhamet Hajrullahu.

Panelistet diskutuan mbi gjuhën e urrejtjes dhe sulmet publike ndaj grave në politikë, rëndësinë e inkurajimit të grave për t'u përfshirë në politikë si dhe nevojën për më shumë demokraci të brendshme brenda partive politike. U theksua se problemet me të cilat përballen qytetarët nuk

kanë gjini dhe se temat që prekin jetën e përditshme duhet të jenë në fokus të debatit politik.

Raporti është hartuar në kuadër të projektit të mbështetur nga Embassy of the Netherlands in Kosovo, me qëllim analizimin e përfshirjes dhe përfaqësimit të grave në zgjedhjet lokale dhe parlamentare 2025, duke shqyrtuar të gjitha fazat e procesit zgjedhor, nga nominimi dhe mbështetja elektorale deri te rezultatet përfundimtare.



Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2024 thuhet se, në rastet e trajtimeve të specializuara jashtë vendit, FSK-ja bashkëpunon me institucionin mjekësor GATA në Ankara të Turqisë.

## Nevoja që rritet me misionet jashtë vendit

Nevoja për kapacitete të avancuara mjekësore është bërë më urgjente edhe me përfshirjen e FSK-së në misione ndërkombëtare. Së fundmi, disa pjesëtarë të saj janë angazhuar në një mision stabilizues në Gazë, nën mandatin e Kombeve të Bashkuara.

Një ekip për verifikimin e situatës në terren është

dërguar atje në fund të prillit, megjithatë Radio Evropa e Lirë nuk ka arritur të konfirmojë nëse me ato forca është dërguar edhe personel mjekësor - çka i shton dilemat mbi mbështetjen shëndetësore në terren. Sipas ekspertit Ibishi, prania e ekipeve ushtarake jashtë vendit forcon ndjeshëm ndjenjën e sigurisë dhe qëndrueshmërisë së trupave. "Nga përvoja ime që kam kaluar në tri luftëra - atë të Sllovenisë, Kroacisë dhe të fundit në Kosovë - unë si ushtarak, me gjithë atë përvojë, jam ndier shumë më mirë dhe më i sigurt kur kemi pasur afër personel mjekësor", thotë ai.

## Siguria e zyrtarëve dhe trajtimi aktual

Sipas Kastratit, spitali ushtarak do të shërbente edhe për arsye sigurie për krerët e shtetit dhe strukturat e larta të sigurisë. "Siguria maksimale garantohej brenda kazermës", thotë ai. Aktualisht zyrtarët e lartë trajtohen në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), e cila konfirmon se nuk ka reparte të veçanta për ta apo për pjesëtarët e FSK-së. "Të gjithë pacientët trajtohen në repartet përkatëse, bazuar në gjendjen e tyre shëndetësore dhe nevojat mjekësore", thuhet në

përgjigjen e QKUK-së për Radion Evropa e Lirë. Aty, po ashtu, theksohet se, në raste të caktuara, mund të kërkohen masa shtesë sigurie nga Policia e Kosovës.

## Rajoni përpara Kosovës

Ndryshe nga Kosova, vendet e rajonit kanë ndërtuar struktura të mirëfillta të mjekësisë ushtarake. Në Shqipëri funksionon Spitali Ushtarak Qendror Universitar që nga viti 1993, i cili ofron shërbime të specializuara për ushtarakët dhe për civilët. Serbia ka një nga spitalet më të mëdha ushtarake në rajon, me kapacitete të gjera infrastrukturore dhe

organizative. Ndërkaq, në Maqedoninë e Veriut operon Qendra Ushtarake Mjekësore, e cila ofron shërbime në disa nivele.

Zyra e zëdhënësit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut konfirmon për Radion Evropa e Lirë se kjo qendër bashkëpunon me sistemin publik shëndetësor për trajtime më të avancuara.

Me doktrinën e NATO-s, ku Kosova synon të anëtarësohet, mbështetja mjekësore ushtarake organizohet në nivele të ndryshme, ku secili prej tyre përfaqëson një hap më të avancuar të trajtimit - nga ndihma e parë në terren deri te kapacitetet spitalore në salla operacionesh.

# FSHAT OLIMPIK E SPITAL MODERN: MOSKOORDINIM E PAQARTËSI PËR INVESTIME MADHORE NË PRISHTINË

Komuna e Prishtinës po promovon para investitorëve të huaj projekte madhore si Spitali i Prishtinës dhe Fshati Olimpik, me ankesa për mungesë të përkrahjes nga institucionet qendrore. Për të dy këto projekte - dhe për projekte të tjera që lidhen me Lojërat Mesdhetare 2030, bashkorganizatore të cilave janë komuna dhe Qeveria e Kosovës - ekzistojnë paqartësi për mënyrën e realizimit

PRISHTINË, 19 MAJ - Në kërkim të investitorëve të huaj për projekte me vlerë prej miliona eurosh, komuna e Prishtinës po promovon disa iniciativa që i paraqet si zhvillimore dhe strategjike për kryeqytetin e Kosovës, ndër to edhe Spitalin e Prishtinës dhe Fshatin Olimpik. Të dyja u paraqitën para investitorëve amerikanë dhe të tjerë ndërkombëtarë në Konferencën e Investitorëve Amerikanë në Prishtinë, organizuar me mbështetjen e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe Ambasadës së Shteteve të Bashkuara në Prishtinë. Por, derisa komuna i sheh këto projekte si mënyrë për të tërhequr kapital privat në mungesë të mbështetjes nga niveli qendror, institucionet qendrore flasin për moskoordinim, ndërkaq shoqëria civile sheh paqartësi në kompetenca dhe rrezik të ndeshjes së projekteve.

## Një stadium futbollit, dy, apo asnjë?

Kosovën e ndajnë edhe rreth katër vjet nga organizimi i Lojërave Mesdhetare, që konsiderohen ndër ngjarjet më të rëndësishme sportive pas Lojërave Olimpikë. Për këto gara të sporteve të lojlojshme duhet infrastrukturë specifike, të cilën Qeveria e Kosovës është zotuar ta ketë gati para fillimit të Lojërave, që parashihen të mbahen në periudhën mes 24 korrikut dhe 4 gushtit 2030.

Pjesa më e rëndësishme e infrastrukturës mbetet ndërtimi i një Stadiumi Kombëtar dhe i Fshatit Mesdhetar, kompleks që do të shërbente për akomodimin e rreth 5 000 sportistëve nga rreth 26 vende pjesëmarrëse.

Më 28 prill, në ditën e dytë të konferencës treditore për investitorë, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, paraqiti një masterplan për një Fshat Olimpik në Bërnice, i cili parashihet stadium futbollit, arena multifunksionale dhe infrastrukturë tjetër sportive.

Kostoja për këtë investim, sipas planit të publikuar nga komuna, është 250 milionë euro, ndërsa ndërtimi i Fshatit është paraparë të bëhet në 60 hektarë tokë publike, rreth 10-15 kilometra në periferi të kryeqytetit.

Shuma e investimit për këtë projekt është e afërt me shumën totale që Qeveria e Kosovës e ka zotuar për investim në lidhje me Lojërat Mesdhetare, sipas ligjit që u miratua në fund të prillit të sivjetmë.

Rama tha për Radion Evropë e Lirë, gjatë Konferencës së Investitorëve Amerikanë, se "niveli qendror [qeveria] kanë qenë bllokues ndaj zhvillimeve në kryeqytet", duke mos i financuar. "Tash po gjejmë

alternativa që me sektorin privat t'i zhvillojmë projektet madhore, të cilat i duhen kryeqytetit, si Unaza e kryeqytetit, si Spitali i kryeqytetit, si Fshati Olimpik, si Stacioni i Autobusëve...", u shpreh kryetari i Prishtinës, më 29 prill.

Në anën tjetër, Ministria e Sportit, që mban rol kyç në organizimin e Lojërave Mesdhetare, tha se projekti që lidhet drejtpërdrejt me garat sportive nuk është ai i komunës. Sipas Fidan Shatrit nga kjo ministri, Fshati Mesdhetar që duhet për Lojërat ekziston si infrastrukturë në qendër të Prishtinës, vetëm se do të rinovohet dhe përshtatet për garat sportive. "Qendra e Studentëve është e paraparë të jetë vendi mikpritës i sportistëve dhe quhet Fshati Mesdhetar", tha ai për Radion Evropë e Lirë, duke shtuar se projekti është në fazën e hartimit të kriterëve dhe tenderimi për projektin pritet të shpallet gjatë këtij viti.

Shatri shtoi se Fshati Olimpik në Bërnice është projekt vetjak i komunës dhe nuk është përfshirë në planin me të cilin Kosova ka aplikuar për të qenë organizatore e Lojërave Mesdhetare. "Projekti të cilin e ka shfaqur komuna e Prishtinës nuk ka ndonjë dakordim të përbashkët me institucionin tonë", deklaroi Shatri, i cili, megjithatë, shtoi se nuk është "diçka e keqe nëse komuna arrin ta realizojë atë investim".

Paqartësitë shkojnë edhe më tej te Stadiumi Kombëtar - një prej investimeve kyçe sportive, që lidhet me organizimin e Lojërave Mesdhetare si i nevojshëm për hapjen dhe mbylljen e tyre.

Sipas Ministrisë së Sportit, lokacioni për stadiumin ende nuk është vendosur. Një opsion për të mbetet Zona Industriale në Drenas, ndërsa edhe Bërnica përmendet si mundësi. Por, ministria thotë se vendimi final për lokacionin nuk ekziston ende.

Madje, sipas Shatrit, meqë futbollit nuk do të jetë pjesë e garave, "për hapje dhe mbyllje të Lojërave Mesdhetare mund të ketë edhe Plan B". Kjo, tha ai, nuk nënkupton që ministria nuk është e interesuar ta ndërtojë stadiumin, pasi ai është i nevojshëm edhe përtej Lojërave. Shatri pohoi se do të ishte pozitive nëse arrihet ndërtimi i dy apo më shumë stadioneve, por theksoi se projekti i komunës nuk është i dakorduar mes dy institucioneve. "Mentalisht nuk është që ka pasur dakordim që komuna ta zhvillojë projektin [për stadiumin], ndërsa atë ta bashkëfinancojë ose financojë Ministria e Sportit", tha Shatri.

Bashkorganizatori i tretë i Lojërave, Komiteti Olimpik i Kosovës (KOK), i sheh si të ndara planet e qeverisë dhe të komunës. Kryetari i KOK-ut, Ismet Krasniqi, tha për Radion Evropë e Lirë se



Fshati Mesdhetar dhe Fshati Olimpik nuk janë i njëjti projekt. "Natyrshisht se do të ishin të mirëseardhura nëse do të investohej në të dyja", u shpreh ai. Megjithatë, edhe ai pranoi se Fshati Olimpik nuk ka qenë pjesë e kandidatës origjinale të Kosovës për organizimin e Lojërave Mesdhetare. Sidoqoftë, sipas tij, çdo ditë që kalon rrit shqetësimin për vonesa në përfundimin e infrastrukturës së nevojshme për Lojërat. "Uroj që... procesi i investimeve do të ecë me hapa të shpejtë, e sidomos procesi i ndërtimit të Stadiumit Kombëtar si projekti më madhor", tha Krasniqi.

Për ekspertët e qeverisjes lokale, fakti që komuna dhe qeveria po flasin paralelisht për projekte të ngjashme tregon mungesë të koordinimit institucional. Bekim Salihu, nga Instituti për Studime të Avancuara - GAP, konsideron se kjo situatë krijon paqartësi për publikun dhe për investitorët. "Kur dy nivele të pushtetit dalin me projekte 'binjake' për të njëjtin funksion, krijohet paqartësi mbi bartësin e mandatit, lokacionin, burimin e financimit dhe afatet", tha ai për Radion Evropë e Lirë. Sipas tij, kjo rrit rrezikun e vonësive, ndryshimeve të konceptit dhe kostove shtesë. "Për opinionin publik dhe sidomos për investitorët, kjo përkthehet në sinjal të dobët serioziteti", tha Salihu.

Ai shtoi se gara politike rreth meritave për Lojërat Mesdhetare po shndërrohet në përplasje për kontroll mbi punimet në lidhje me këto lojëra. "Në vend të organizimit, çështja është kthyer në bajraktarizëm dhe individualizëm", deklaroi ai. Komuna e Prishtinës tha, pas Konferencës së Investitorëve Amerikanë, se ka nënshkruar 58 letra të interesit nga investitorë potencialë për 19 projektet e paraqitura, por zyrtarë të saj nuk iu përgjigjën pyetjeve të Radios Evropë e Lirë se sa nga to ishin në lidhje me Fshatin Olimpik.

Projekte të tjera të paraqitura përfshinin edhe Stacionin e Autobusëve, Shtëpi Moderne të Pleqve e deri tek unaza rrugore në Prishtinë, për të cilën Rama, po ashtu, tha se ka munguar përkrahja nga niveli qendror.

## Spital publik, privat apo fare?

Me mungesë koordinimi dhe shkëmbime fajesh është përcjellë edhe projekti i kamotshëm për Spitalin e kryeqytetit. Aktualisht për banorët e Prishtinës nuk ekziston spital publik, derisa shërbimet spitalore ata duhet t'i marrin në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), një institucion ku marrin shërbime të specializuara qytetarë nga e gjithë Kosova. Kjo shënon një ngarkesë shtesë për këtë qendër, ndërsa lë mangët kryeqytetasit.

Ndërtimi i Spitalit të Prishtinës ka qenë ndër premtimet kryesore të kryetarit aktual të Prishtinës, Rama. Komuna, madje, ka ndarë parcelën e tokës për ndërtimin e tij, si dhe një buxhet fillestar për projektin. Megjithatë, këtë Spital, komuna e paraqiti si projekt potencial për investim të jashtëm në Konferencën e Investitorëve Amerikanë.

Projekti, sipas planit të komunës, mund të kushtojë 90 milionë euro, me lokacion në zonën e njohur si Prishtina e Re. Por, në projekt nuk është bërë e qartë se si saktësisht do të funksiononte ai, duke lënë të hapur mundësinë për partneritet publiko-privat, koncesion e modele të tjera. Kryetari Rama tha se komuna është detyruar të kërkojë alternativa të investimeve të huaja për shkak të mungesës së mbështetjes nga Qeveria e Kosovës. Por, Ministria e Shëndetësisë e sheh ndryshe çështjen, duke thënë se kërkohet diskutim më i gjerë për nevojën reale për këtë spital.

Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Arben Vitia, duke folur për gazetarët më 4 maj 2026, tha se ndërtimi i një spitali nuk mund të trajtohet vetëm si projekt ndërtimor. "Së pari duhet një marrëveshje dhe koordinim i afërt mes komunës së Prishtinës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe QKUK-së", deklaroi Vitia.

Ai tha se spitali duhet të jetë komplementar me sistemin ekzistues shëndetësor dhe të ndihmojë në uljen e ngarkesës në QKUK. "Ne nuk mund të themi që po ndërtojmë një ndërtesë, sepse ajo mund të jetë pjesa më e lehtë", tha Vitia. Sipas tij, pa

koordinim ekziston rreziku që të krijohet një institucion i ri që kërkon mirëmbajtje të kushtueshme, por nuk sjell përmirësim real të shërbimeve. Megjithatë, ministria nuk iu përgjigj pyetjeve specifike të Radios Evropë e Lirë se a e mbështet projektin e paraqitur nga komuna dhe si do të mund të funksiononte ky spital në hierarkinë e shëndetësisë publike.

Edhe këtu ekspertët ngrenë pikëpyetje për mënyrën se si po ndryshon koncepti i projektit.

Salihu nga GAP-i konsideron se ideja që Spitali i Prishtinës të financohet nga donatorë ose investitorë privatë përbën devijim nga koncepti fillestar i një projekti publik. "Në momentin kur komuna ka aprovuar ndarjen e pronës komunale për ndërtimin e spitalit, projekti është paraqitur si investim publik me qëllim shërbimin publik", tha ai. Sipas tij, kalimi drejt financimit privat krijon paqartësi për mënyrën e menaxhimit dhe funksionimit të spitalit. "Edhe nëse spitali synon të mbetet 'publik' në status, futja e një financuesi të jashtëm e rrit rrezikun e një modeli hibrid ku standardet e shërbimit, qasja, organizimi i shërbimeve dhe autonomia menaxheriale mund të mos jenë më të përcaktuara qartë nga interesi publik, por të negociohen sipas logjikës së marrëveshjes me donatorin", tha Salihu.

## Çfarë mendojnë investitorët?

Pikërisht çështja e sigurisë politike dhe institucionale është një nga rezervat që përmendin edhe investitorët e huaj për futjen e aseteve të tyre në Kosovë. Në Konferencën e Investitorëve Amerikanë morën pjesë përfaqësues të kompanive amerikane dhe investitorë me përvojë në rajon, të cilët thanë se Kosova ka potencial, por mbetet sfiduese për shkak të klimës politike dhe burokracisë.

Kolec Ndoja, investitor shqiptaro-amerikan dhe përfaqësues i kompanisë DOME Equities nga Florida, tha se e sheh Prishtinën si "qytet në lëvizje", por pranoi se investimi jashtë një sistemi të konsoliduar si ai amerikan mbetet sfidë.

"Ka rezistencë dhe burokraci që në shumë raste mund të paraqiten", tha ai për Radion Evropë e Lirë. Megjithatë, ai shtoi se investitorët po e shohin Prishtinën si mundësi zhvillimi afatgjatë. "Shohim një qytet vibrues dhe kryeqytet të Kosovës që mund të bëhet destinacion për të gjithë Evropën", deklaroi Ndoja. Ai tha se investitorët janë të vetëdijshëm për sfidat politike, por besojnë se projektet e mëdha mund të krijojnë vull të ri ekonomik.

## Shkurte Fejza takon ish-presidentin Clinton: Mirënjohje nga zemra në emër të popullit të Kosovës

PRISHTINË, 19 MAJ - Këngëtarja e njohur shqiptare Shkurte Fejza ka takuar në ShBA ish-presidentin Bill Clinton. Lajmin e ka bërë me dije vetë këngëtarja në rrjetet sociale.

Shkurte Fejza ka thënë se ky takim ishte një moment falënderimi dhe mirënjohjeje të thellë për gjithçka që ish-presidenti Clinton ka bërë për Kosovën. "Në emrin tim dhe në emër të gjithë atyre që e bartin

Kosovën në zemër, dje në Shtetet e Bashkuara pata nderin e veçantë të takoj presidentin Bill Clinton. Ky takim ishte më shumë se simbolik. Ishte një moment falënderimi dhe mirënjohjeje të thellë për gjithçka që presidenti Clinton ka bërë për Kosovën, për vendimin historik, për guximin moral dhe për qëndrimin e palëkundur në anën e së drejtës, në ditët më të errëta të popullit tonë. Pa atë

angazhim vendimtar, liria jonë do të kishte një histori tjetër. Një falënderim i veçantë shkon edhe për shqiptarët e Amerikës, shqiptaro-amerikanët, zemra e gjallë e shqiptarizmes, zëri ynë i palëkundur në kohë rreziku dhe shtylla e fuqishme e miqësisë së përhershme mes Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara. Liria e Kosovës mban edhe emrin e ndërgjegjes amerikane, dhe ky emër do të kujtohet përjetë me



## XHANDARMËRIA E KOSOVËS DREJT THEMELIMIT, MPB-JA NIS PROCEDURAT PËR KRIJIMIN E SAJ

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 19 MAJ - Ministri në detyrë i Punëve të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se janë ndërmarrë hapat e parë drejt themelimit të xhandarmërisë së Kosovës. Sveçla shkroi në rrjetet sociale se ka nënshkruar themelimin e grupit punues që, sipas tij, do ta bëjë analizimin dhe propozimin e modaliteteteve për funksionimin e xhandarmërisë si Agjenci e MPB-së.

"Xhandarmëria përfaqëson një hap të rëndësishëm në konsolidimin e arkitekturës sonë të sigurisë, me mision të qartë për të garantuar prezencë të



fuqishme shtetërore në funksion të ruajtjes së kufijve, integritetit dhe sovranitetit tonë territorial, mbrojtjen nga terrorizmi,

menaxhimin e trazirave me rrezikshmëri të lartë dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike", shkroi ai në Facebook.

Sipas Sveçlës, krijimi i xhandarmërisë do t'forcojë kapacitetet shtetërore për parandalimin, menaxhimin dhe neutralizimin e kërcënimeve "që cenojnë sigurinë e qytetarëve dhe integritetin territorial të vendit tonë.

Xhandarmëria është një forcë e sigurisë me karakter ushtarak që kryen detyra policore. Në disa shtete mund të jetë pjesë e Ministrisë së Brendshme, në të tjera pjesë e forcave të armatosura.

Shumë shtete kanë xhandarmërinë e tyre, përfshirë edhe fqinji verior i Kosovës, Serbia, xhandarmëria e së cilës funksionon në kuadër të policisë.

Xhandarmëri kanë edhe shtete të tjera, sikurse Franca, shtet anëtar i NATO-s.

Shembull, Xhandarmëria e Francës është forcë ushtarake që ka për detyrë sundimin e ligjit, ka juridiksion të plotë mbi popullatën civile dhe është përgjegjëse për sigurinë publike, rendit publik dhe ndërvepron me forcat policore dhe ushtarake brenda dhe jashtë vendit. Ajo luan rol në menaxhimin e krizave dhe merr pjesë edhe në misione paqësore jashtë vendit, por edhe në operacione luftarake.

Në NATO, forcat e llojit të xhandarmërisë përmenden në kuadër të asaj që njihet si policia për stabilitet.

## KUFIZIMET PËR USHTRIMIN PARALEL TË FUNKSIONEVE PUBLIKE NË KUVENDET KOMUNALE NDIKOJNË NË CILËSINË E PËRFAQËSIMIT DHE VENDIMMARRJES LOKALE

PRISHTINË, 19 MAJ - Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK) ka organizuar takimin e parë të Kolegjiumit të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave në kuadër të procesit të konsolidimit të strukturave të reja të dala nga zgjedhjet e fundit lokale.

Qëllimi i takimit ishte informimi i kryesuesve të kuvendeve komunale lidhur me mandatin dhe rolin e AKK-së si dhe avancimi i bashkëpunimit me synim fuqizimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

Në fokus të diskutimeve ishte ndikimi i Ligjit për Zyrarët Publikë dhe dispozitave për

konflikt interesi në përbërjen e kuvendeve komunale.

Në takim u theksua se kufizimet për ushtrimin paralel të funksioneve publike dhe mandatit politik lokal kanë ndikuar në uljen e përfshirjes së profesionistëve nga fusha të ndryshme, veçanërisht nga arsimit, shëndetësia dhe administrata civile.

Si pasojë, është vërejtur një rënie e pranisë së kuadrove profesionale në kuvendet komunale, me ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e përfaqësimit dhe vendimmarrjes lokale.



Një çështje tjetër e trajtuar ishte funksionimi i komiteteve, komisioneve dhe trupave konsultative të kuvendeve komunale. Pjesëmarrësit theksuan se

mungesa e kompensimit për anëtarët e këtyre strukturave ka ndikuar negativisht në nivelin e pjesëmarrjes, motivimin dhe efikasitetin e tyre, duke ngritur nevojën për adresim

institucional dhe zgjidhje të qëndrueshme financiare.

Në kuadër të takimit u zhvillua edhe procesi i zgjedhjes së strukturave drejtuese të Kolegjiumit të Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave.

Kryesuese e Kolegjiumit u zgjodh Krenare Latifi-Kqiku, ndërsa zëvendëskryesues u zgjodh Enver Rugova.

Takimi përfundoi me pajtimin për koordinim institucional në adresimin e sfidave të përbashkëta që lidhen me funksionimin dhe fuqizimin e kuvendeve komunale në Republikën e Kosovës.

## Hamza në familjen Dani: Kosova po humbet të rinjtë nga krizat politike, qytetarët kërkojnë shpresë dhe ndryshim

PRISHTINË, 19 MAJ - Kryetari i Partisë Demokratike e Kosovës dhe kandidati për kryeministër, Bedri Hamza, ka vizituar familjen e Fadil Danit në Fushë-Kosovë, ku ka dëgjuar nga afër shqetësimet dhe sfidat me të cilat po përballen qytetarët. Përmes një videomesazhi të publikuar në rrjetet sociale,

kryefamiljari Fadil Dani tha se kriza ekonomike, mungesa e perspektivës dhe largimi i të rinjve janë sot ndër problemet më të mëdha që po prekin familjet e Kosovës. "Kur një i ri mendon më shumë si të ikë nga vendi sesa si ta ndërtojë jetën këtu, atëherë është alarm për të gjithë ne", tha Dani.

Hamza theksoi se Kosova ka nevojë për më shumë bashkëpunim, stabilitet dhe politika që krijojnë shpresë për qytetarët, e jo për "konflikte e përçarje të pafundme politike". Sipas tij, familjet e Kosovës meritojnë më shumë siguri, zhvillim ekonomik dhe besim për të ardhmen në vendin e tyre.



**GAP-i: Komunat paguan 126.6 milionë euro vitin e kaluar për vendime gjyqësore dhe përmbarimore**

**PRISHTINË, 19 MAJ** - Komunat e Kosovës paguan 126.6 milionë euro për vendime gjyqësore dhe përmbarimore në vitin 2025, një rritje prej 47 % krahasuar me vitin 2024. Nga çfarë vijnë këto obligime gjyqësore dhe përmbarimore? Kontratat kolektive në arsim dhe shëndetësi; Vendimi qeveritar i 2008-s për pagesë shtesë bazuar në kualifikim; Kompensime për shujta, transport dhe inflacion për

shërbyes civilë; Vonesa në pagesa ndaj furnitorëve dhe projekte kapitale të dështuara. "Këto janë para të taksapaguesve që shkojnë për të paguar gjoba dhe detyrime ligjore të komunave, para që mund të ishin shpenzuar për rrugë, shkolla dhe shërbime për qytetarët. Komunat me rritjen më të madhe të pagesave sipas GAP-it janë Prishtina nga 10.6 milionë euro në 45.7 milionë (+332

për qind), Leposaviqi nga 168 mijë euro në 707 mijë euro (+319 për qind, Mamusha nga 51 mijë euro në 179 mijë euro (+249 për qind), Ferizaj nga 3.3 milionë euro në 8.2 euro (+153 për qind) dhe Prizreni nga 5.6 milionë euro në 12.7 milionë euro (+128 për qind). Ndërsa disa komuna arritën të ulin pagesat: Peja: -66 %, Fushë-Kosova: -41 %; Dragashi: -55 %.

**KOSOVA PO NDËRTON NJË SISTEM TË RI DIGJITAL TË PUNËSIMIT**

**PRISHTINË, 19 MAJ** - Ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, ka thënë se platforma ePunësimi do ta transformojë mënyrën se si qytetarët kërkojnë punë, bizneset gjejnë punëtorë dhe institucionet ofrojnë shërbime. Ai ka treguar se në kuadër të punëtorisë "Përmirësimi i Shërbimeve të Punësimi në Kosovë përmes Platformës Digjitale dhe proceseve të bazuara në evidenca", u paraqit përparimi i arritur në zhvillimin e platformës së re digjitale ePunësimi, e cila synon modernizimin dhe

digjitalizimin e shërbimeve të punësimi në Republikën e Kosovës.

Përmes platformës ePunësimi: Punëkërkuarit do të mund të aplikojnë online, të ndërtojnë profile profesionale dhe të marrin mbështetje për zhvillimin e karrierës; Punëdhënësit do të kenë qasje më të shpejtë dhe më efektive në menaxhimin e vendeve të lira të punës dhe identifikimin e kandidatëve adekuatë; Institucionet do të kenë një sistem të integruar dhe modern për ofrimin e shërbimeve publike.

Një nga elementet kryesore të



platformës është integrimi me institucionet relevante shtetërore, përfshirë Agjencinë e Regjistrimit Civil, ATK-në, ARBK-në, Thesarin, eKosova dhe sisteme të tjera relevante, duke mundësuar automatizim të proceseve dhe rritje të besueshmërisë së të dhënave.

Po ashtu, integrimi i platformave ekzistuese si SIMP, Superpuna, KGenU dhe ueb-faqes së APRK-së në një sistem unik digjital do të krijojë një qasje të centralizuar dhe më funksionale për qytetarët, bizneset dhe institucionet.

**REFORMA SOCIALE, ZHVILLIMI NJERËZOR DHE POLITIKAT E PUNËS, TEMË DISKUTIMI MES HOTIT DHE BB-së**

**PRISHTINË, 19 MAJ** - Reforma sociale, zhvillimi njerëzor dhe politikat e punës ishin në qendër të takimit të ministrit për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare, Andin Hoti, me përfaqësuesit e Bankës Botërore.

Në takim u diskutua për vizionin e Qeverisë së Kosovës në zhvillimin e politikave sociale dhe të punës, me theks në ndërtimin e një sistemi më të drejtë, gjithëpërfshirës dhe funksional të mbrojtjes sociale.

Gjatë takimit Michal Rutkowski, drejtor Rajonal për Zhvillim Njerëzor në Evropë

dhe Azi Qendrore në Bankën Botërore, informoi Ministrin Hoti lidhur me progresin e Projektit për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale në Kosovë, si dhe për hapat dhe prioritetet kryesore për periudhën e ardhshme.

Ministria e Punës, Familjes dhe Vlerave të Luftës Çlirimtare vlerëson partneritetin dhe mbështetjen e vazhdueshme të Bankës Botërore në avancimin e reformave sociale dhe zhvillimin e politikave që synojnë përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të Republikës së Kosovës.

**Trusti kalon shifrën e 4 miliardë eurove mjete në menaxhim**

**PRISHTINË, 19 MAJ** - Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) ka njoftuar se gjatë muajit maj 2026 mjetet neto në menaxhim kanë tejkaluar shifrën prej 4 miliardë eurosh. Sipas njoftimit të Trustit, rreth 70 për qind e kësaj shume është

akumuluar nga kontributet pensionale të qytetarëve, ndërsa afërsisht 30 për qind paraqet kthimin nga investimet.

Nga të dhënat e publikuara theksohet se fondi ka shënuar rritje të vazhdueshme ndër vite.

Në fund të vitit 2015 FKPK-ja kishte rreth 1.2 miliard euro mjete në menaxhim, ndërsa tani kjo vlerë ka kaluar 4 miliardë euro.

Trusti vlerëson se rritja e mjeteve nën menaxhim është rezultat i kontributeve të

vazhdueshme pensionale dhe performancës së investimeve në vitet e fundit.

Në njoftim është publikuar edhe një grafik që paraqet ecurinë e rritjes së mjeteve në menaxhim nga viti 2015 deri në maj të vitit 2026.



# MAKINERIA E MADHE E MEDIOKRITETIT. SI PO E RRAFSHON INTELIGJENCA ARTIFICIALE SHKRIMIN E MIRË

Inteligjenca Artificiale mund të duket sikur ka demokratizuar shkrimin, por e vërteta është se ka industrializuar mediokritetin. Letërsia, në fund të fundit, nuk ishte menduar kurrë të ishte e lëmuar dhe e kollajtë. Ajo duhej të ishte e ashpër, kundërshtuese dhe, mbi të gjitha, njerëzore

Diku mes viteve 1953-54, Roald Dahl shkroi një tregim të shkurtër me titull "Gramatizuesi i madh automatik". Protagonisti i tij, Adolph Knipe, ndërton një makinë që mund të "prodhojë një histori me pesë mijë fjalë, të daktilografuar dhe gati për t'u dërguar, për tridhjetë sekonda". Makina furnizohej "me subjekte" dhe më pas "shkruante fjalitë".

Më pas, Knipe u afrohet shkrimtarëve më të suksesshëm të vendit me një pazar djallëzor: pranoni pagesë të përjetshme, mos shkruani më asnjë fjalë dhe lejoni që makina të botojë nën emrin tuaj.

Shumica e autorëve pranojnë, sidomos ata më mediokrit, të lodhurit dhe që dikur kishin qenë të famshëm, por tashmë u kishin shteruar idetë. Shkrimtarët më të rinj dhe më të talentuar rezistojnë, por në fund edhe ata detyrohen të dorëzohen. Autorët njerëzorë zhduken nga profesioni. Letërsia mbijeton, por jo shkrimtarët.

Shtatëdhjetë vjet më vonë, ne po jetojmë brenda profecisë së Dahlit. Vetëm se tani, makina quhet "inteligjencë artificiale" (IA).

## Paradoksi i çuditshëm tek Inteligjenca Artificiale

Inteligjenca Artificiale mund të duket sikur e ka demokratizuar shkrimin, por e vërteta është se ajo ka industrializuar mediokritetin. Po, sot çdokush mund të prodhojë një artikull të mirë. Gramatika nuk ka fare të meta. Pikësimi është i rregullt.

Gabimet drejtshkrimore janë zhdukur. Por bashkë me to është zhdukur edhe ai lloj shkrimi që mund të quhej i freskët, origjinal dhe provokues.

Ky është paradoksi i çuditshëm i epokës së Inteligjencës Artificiale: zhdukja e shkrimit të keq ka sjellë edhe rënien e shkrimit të mirë. Po hyjmë në një epokë të sunduar nga ligji i mesatares, ku të gjithë shkruajnë mjaftueshëm mirë, por hapësira për shkrimin magjepsës po tkurret dita-ditës.

Të shkruarit po fillon të ndihet frikshëm i ngjashëm. Gabimet janë zhdukur, por bashkë me to edhe surprizat. Fjalitë janë të sakta, por edhe të parashikueshme. Gjuha është e

lëmuar, por e zbehtë dhe pa jetë.

Shkrimet e mëdha lindin nga eksperimentimi. Shpesh burojnë nga rreziqet, nga përpjekjet e dështuara, nga struktura të çuditshme fjalish që në fund bëhen të bukura. Nëse shkrimtarët ndalojnë së luftuari me gjuhën sepse një makinë u ofron menjëherë fraza të përsosura, si do ta zbulojnë zërin e tyre? Nëse dikush nuk shkruan kurrë keq, si do ta kuptojë çfarë është vërtet shkrimi i mirë? Ky është rreziku i vërtetë.

## Vdekja e origjinalitetit

Inteligjenca Artificiale lulëzon mbi modele. Ajo parashikon çfarë vjen më pas bazuar në atë që ka ndodhur më parë. Kjo e bën efikase, por njëkohësisht konservatore në thelb, si dhe të parashikueshme. Siç vëren Knipe i Dahlit, shkrimi i një makinerie "qeveriset nga rregulla pothuajse matematikore në ngurtësinë e tyre! Duke pasur fjalët dhe kuptimin e asaj që duhet thënë, ekziston një dhe vetëm një renditje e saktë në të cilën ato fjalë mund të vendosen".

Kjo bie ndesh me rendin natyror të shkrimit, i cili nuk është thjesht renditje e fjalëve gramatikisht të sakta, por ritëm, rebelim dhe obsesion. Ai i përket shkrimtarit që shkel gramatikën për hir të bukurisë, që shpik fjalë kur ato ekzistueset nuk mjaftojnë dhe që e përkuq gjuhën, derisa ajo të zbulojë diçka të re. Ai i përket eksperimentimit. Dhe sundohet nga ata që jetojnë e lulëzojnë në zonat gri të krijimit.

Por Inteligjenca Artificiale preferon sigurinë. Ajo e rrafshon gjuhën, i zbut skajet dhe eliminon parehatinë. E kombinuar me fiksimin ndaj korrektesës politike dhe frikën për të mos ofenduar askënd, shkrimi bëhet i sigurt dhe i lëmuar, por gjithnjë e më steril. Kjo më kujton një nga bashkëpunëtorët e mia. Sa herë që dërgon një artikull, ajo më thotë se e ka shkruar vetë dhe se nuk e ka "lustruar" as me ndihmën e Inteligjencës Artificiale. Nuk është ndonjë shkrimtare e madhe, por herë pas here më befason me disa fjalë, me disa ide. Ajo eksperimenton, ndonjëherë funksionon, shumë herë jo. Por unë do të zgjidhja çdo ditë një artikull jo të përsosur, plot me



risqe letrare dhe gabime gramatikore, sesa një tekst të përsosur teknikisht, por emocionalisht bosh.

Një tjetër sfidë që sjell Inteligjenca Artificiale është origjinaliteti. Kur lexon një artikull sot, shpesh pyet veten: zëri i kujt është ky, i autorit apo i makinerisë? Siç më tha së fundmi një miku im studiues, "nuk e di nëse ajo që po lexoj është këndvështrimi i autorit apo i kompjuterit. Është një sfidë reale për ne në fushën e kërkimit dhe shkrimit."

## Kostoja psikologjike e "komoditetit"

Kërcënimi nuk është vetëm artistik; është edhe ekonomik dhe psikologjik.

Siç paralajmëron Naomi S Baron në librin e saj "Kush e shkroi këtë?", shkrimi është një proces zbulimi, përmes përpjekjes krijuese të shkrimtarit dhe shumë varianteve të dështuara. "Nëse makineritë bëjnë punën tonë për ne, nuk është e qartë si do të jetojmë. Edhe nëse shpërndarja universale e të ardhurave bëhet realitet, çfarë ndodh me psikikën e miliona

njerëzve që marrin vetëvlerësim nga puna që duan? Shumë nga këto punë përfshijnë prodhimin, redaktimin ose përkthimin e prozës së shkruar. Unë, për vete, shkruaj sepse ka gjëra për të cilat dua të mendoj dhe t'i ndaj me të tjerët. Variantet e shumta janë pjesë e procesit të zbulimit. Do ta urreja t'i shihja këto mundësi të uzurpuara," shkruan ajo.

Një aspekt edhe më i rrezikshëm i asaj që Baron e quan "zbutja e IA" qëndron në faktin se, në afatgjatë, mund të bëhemi të paafte për të shkruar, sidomos gjëra të mira. Ashtu si makinat që parkohen vetë mund t'i bëjnë shoferët të harrojnë si bëhet parkimi paralel, IA mund t'i bëjë njerëzit të harrojnë gradualisht si shkruhet. Shumë të rinj tashmë kanë vështirësi me shkrimin e gjatë me dorë sepse rrallë përdorin stilolaps dhe letër. Duart nuk i kanë të stërvitura. Inteligjenca Artificiale rrezikon ta çojë këtë rënie edhe më tej, jo vetëm duke dobësuar shkrimin fizik, por edhe atë mendor.

Një qytetërim që nuk mund të shkruajë, do të humbasë aftësinë për të menduar në

mënyrë të pavarur. Ky është një skenar tmerrues në çdo kuptim.

## A ka marrë fund gjithçka?

Shpresojmë që situata të mos jetë plotësisht jashtë kontrollit. Qeniet njerëzore e kanë habitur vazhdimisht vetveten me instinktin e tyre të mbijetesës. Megjithatë, sfida e sotme duket ndryshe sepse kundërshtari nuk është haptazii armiqësor. Ai ka ardhur si mik. IA premton rehati, shpejtësi, efikasitet dhe lehtësi. Ofron ndihmë, jo shkatërrim.

Dhe pikërisht kjo e bën të rrezikshme. Kërcënimi është i padukshëm. Nuk të kërkon të ndalosh së shkruari; të inkurajon të ndalosh së provuari. Dhe ndoshta kriza më e madhe nuk është vetëm vdekja e shkrimit, por edhe vdekja e leximit. Në një epokë ku postimet në rrjetet sociale ngatërrohen me letërsinë dhe botuesit ndjekin famën virale në rrjetet sociale më shumë sesa thellësinë intelektuale, etja për lexim serioz po zvogëlohet. Kur popullariteti zëvendëson substancën dhe dukja zëvendëson mendimin, letërsia bëhet performancë, jo kërkim.

## Nëse nuk ka lexues të mirë, si do të lindin shkrimtarët e mirë?

Megjithatë, ky nuk është një argument kundër teknologjisë. Është një argument kundër dorëzimit.

Përdoreni Inteligjencën Artificiale si mjet, nëse duhet, por mos e lini kurrë të bëhet zëri juaj. Shkruani keq, shkruani ngadalë, shkruani me dhimbje dhe rishkruani, nëse është e nevojshme. Letërsia, në fund të fundit, nuk ishte menduar kurrë të ishte e lëmuar dhe e kollajtë. Ajo duhej të ishte e ashpër, kundërshtuese, reflektuese dhe, mbi të gjitha, njerëzore.

Roald Dahl e kishte parë këtë shumë kohë më parë: rrezikun e shkrimit të makinerive për njerëzit. Nëse humbasim shkrimin, nuk humbasim vetëm librat e mirë. Humbasim vetë aftësinë për të menduar. / Utpal Kumar – FirstPost – Bota.al



## Ronaldo udhëheq Portugalinë në Botëror

LISBONË, 19 MAJ - Kombëtarja e Portugalisë ka publikuar zyrtarisht listën e futbollistëve të ftuar për Kampionatin Botëror që do të zhvillohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Meksikë dhe Kanada. Lista e publikuar ka ngjallur menjëherë interesim të madh te tifozët portugezë,

ndërsa vëmendja kryesore ka qenë te prania e legjendës Cristiano Ronaldo. Pavarësisht prej moshës, Ronaldo vazhdon të mbetet pjesë kyçe e Kombëtares së Portugalisë dhe do të jetë sërish lideri i skuadrës në një tjetër Botëror, duke dëshmuar edhe një herë rëndësinë dhe ndikimin e tij

te përfaqësuesja portugeze. Trajneri Roberto Martinez ka vendosur t'i besojë përvojës së yllit portugez, i cili vazhdon të jetë një nga figurat më të rëndësishme në dhomat e zhveshjes dhe në fushën e lojës. Ky pritet të jetë një tjetër kapitull historik për Cristiano Ronaldon, i cili vazhdon të

thyejë rekorde dhe të mbetet një nga emrat më të mëdhenj në historinë e futbollit botëror. Tifozët portugezë tashmë presin me shumë interes debutimin e ekipit në Botëror, me shpresën se Portugalia do të luftojë për trofeun më prestigjioz në futbollin botëror.



## SHKON SILVINJO VJEN ROLANDO MARANI NË KRYE TË KOMBËTARES SË SHQIPËRISË

TI RANË, 19 MAJ - Rolando Maran është zyrtarisht trajneri i ri Kombëtares shqiptare. Ky zyrtarizim ka ndodhur pas largimit të trajnerit Silvinjo. Përmes një konference për medie, në ambientet e "Shtëpisë së Futbollit", presidenti i Federatës së Futbollit Shqiptar (FFSh), Armand Duka, ka paraqitur trajnerin e ri të ekipit kombëtar, Rolando Maran, i cili ka firmosur një kontratë për 1 vit e gjysmë me FShF-në. Ndihej i tij në stolin kuqezi do të jetë Christian Maraner, i cili, gjithashtu, ka firmosur kontratë me FShF-në. Presidenti Duka ka sqaruar edhe hollësitë e arritura me trajnerin e ri të ekipit kombëtar, duke nënvizuar se objektivi është vendi i parë në Nations League dhe kualifikimi i skuadrës në finale të Europianit 2028. Presidenti i FShF-së ka falënderuar në mënyrë të

veçantë ish-stafin e ekipit kombëtar, në krye me Silvinjon, për të gjithë arritjet dhe sukseset në krye të kombëtares shqiptare. "Mirë se keni ardhur sot në këtë ditë të rëndësishme për ekipin kombëtar dhe FShF-në, në të cilën ne do të bëjmë publik emrin e trajnerit të ri të ekipit kombëtar Rolando Maran. Në të njëjtën kohë ne mbyllim një cikël me ish-trajnerin e ekipit kombëtar Silvinjo dhe stafin e tij, të cilët dua t'i falënderoj në emër të FShF-së, emrin tim dhe të gjithë tifozëve për kontributin që kanë dhënë Silvinjo, Doriva dhe Zabaleta gjatë kësaj periudhe për Kombëtaren shqiptare, për rezultatet e arritura. Bashkë kemi kaluar një periudhë të rëndësishme, me shumë emocione, kemi qeshur e qarë, kemi gëzuar bashkë. Është pjesë e historisë edhe personale, edhe e të gjithë futbollit shqiptar. Silvinjo dhe stafi i tij, por në



futboll mund të konsiderohet normale që mbyllet një cikël apo edhe fillon një cikël i ri. Me një mirëkuptim të plotë dhe një respekt reciprok, me Silvion, Dorin dhe Zabaletën kemi menduar dhe kemi rënë në konsensus që ky cikël duhet mbyllur për të hapur një cikël të ri. Me një trajner jo të ri në moshë, por me një trajner me shumë përvojë, siç është Rolando Maran. Ekipi kombëtar e ka vendosur stekën e vet, apo

nivelin aty ku ne dëshirojmë. Objektivat mbeten vendi i parë në Nations League, kualifikimi në EURO 2028 dhe më pas për të vazhduar me objektivin e paarrtur ndonjëherë për të qenë pjesë e Botërorit 2030", ka thënë Duka. Ndërsa trajneri i ri i ekipit kombëtar, Rolando Maran, është shprehur shumë i lumtur për detyrën e re dhe ka falënderuar presidentin Duka për besimin, ndërsa ka komplimentuar edhe

ish-trajnerin Silvinjo për të gjithë punën e bërë me kuqezinjtë përgjatë viteve. Ai ka thënë se synon që Shqipërinë ta dërgojë në Botërorin e ardhshëm. "Kjo është ëndrra ime, ashtu siç është edhe e juaja. Momentalisht, ëndrra ime është ëndrra juaj: të arrij të sjell ato rezultate që të gjithë i dëshirojmë. Nëse jam këtu, do të thotë që kam bindjen se me përkushtim, me një grup të bashkuar dhe me pak fat, kjo gjë mund të arrihet", ka thënë Marani. Kurse trajneri i deritashëm i kombëtares shqiptare, Silvinjo ka thënë se Shqipëria do të mbetet gjithmonë speciale për të. "Tani e njoh shumë mirë Shqipërinë, Tiranën dhe dua t'ju falënderoj shumë. Falënderoj edhe presidentin për besimin, për punën, sigurisht mbi 100 njerëz që punojnë në këtë federatë", ka thënë Silvinjo.

## BARCELONA NUK KA HEQUR DORË NGA MURIQI



MALLORCA, 19 MAJ - Sullmuesi i Kombëtares së Kosovës, Vedat Muriqi, është ende në listën e përforcimeve të skuadra e Barcelonës. Vështirësitë financiare dhe nevoja për të blerë një sullmues për ta zëvendësuar Robert Lewandoskin, kanë bërë që te Barcelona të mos heqin dorë nga Muriqi. Në të

vërtetë, te Barcelona po shpresojnë që Mallorca të bie nga La Liga pasi në këtë mënyrë do të jetë i detyruar t'i shesë disa prej lojtarëve kryesorë, në mesin e tyre edhe Muriqin me çmim të lirë. Mallorca këtë fundjavë do ta mësojë fatin e saj në La Liga, ndonëse misioni për të mos

rënë në kategorinë e dytë do të jetë tejet i vështirë. Në rast se Mallorca largohet nga elita, atëherë Barcelona mund t'i sigurojë shërbimet e Muriqit për të paktën 10 milionë euro, ndonëse "Pirati" po kërkohet edhe nga klubet në Turqi. Trajneri Hansi Flick është duke e parë Muriqin si të dobishëm te Barcelona, duke

pasur parasysh se sullmuesi i Kosovës ka shkëlqyer këtë sezon në kampionatin spanjoll. Muriqi ka shënuar 22 gola në 36 ndeshje në La Liga dhe është golashënuesi i dytë në kampionat pas Kylian Mbappes që ka dy gola më shumë, ndërsa me Mallorcan ka kontratë deri në vitin 2029.

## Rudiger nuk do të largohet nga Real Madridi


MADRID, 19 MAJ - Mbrojtësi gjerman Antonio Rudiger pritet ta vazhdojë aventurën me gigantin spanjoll Real Madrid, pasi ka pranuar zyrtarisht ofertën e klubit për rinovimin e kontratës. Sipas raportimeve të gazetës spanjolle "AS", Rudiger ka dhënë "dritën jeshile" për ta vazhduar qëndrimin e tij në

"Santiago Bernabéu", duke u bërë pjesë e projektit të "Los Blancos" edhe për të paktën një sezon tjetër, transmeton "Klankosova.tv". Qendërmbrojtësi gjerman ka qenë një nga shtyllat kryesore të mbrojtjes së Real Madridit që prej ardhjes së tij në klub, duke fituar besimin e stafit teknik dhe duke u shndërruar

në një element të pazëvendësueshëm në formacion. Fillimisht Rudiger kishte kërkuar një kontratë dyvjeçare për të siguruar më gjatë të ardhmen e tij në Madrid, megjithatë në fund ka pranuar politikën e klubit spanjoll, i cili zakonisht pëlqen rinovime më

afatshkurtra për futbollistët me moshë dhe përvojë më të madhe. Me këtë vendim, Real Madridi siguron vazhdimësinë e një prej lojtarëve më të rëndësishëm në repartin defensiv, ndërsa Rudiger mbetet i fokusuar në objektivat e mëdha të klubit në garat vendore dhe ato evropiane.





Në mbështetje të nenit 8, nenit 10 nën par. 2.2 dhe nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 01.12.2010, lidhur me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ MFPT - Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik i cili është pjesë e Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës i cili është i shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 31.10.2017, dhe nenit 18 dhe nenin 22 të Rregullores Nr. 13/25 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të miratuar nga Bordi i Drejtorëve të N.P.L. "Përparimi" Sh. A. e duke u bazuar në vendimin me nr. të protokollit 1167/26 të datës 19.05.2026 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L. "Përparimi" Sh. A. me datë 19.05.2026 shpall:

### KONKURS PUBLIK I JASITËM

- I. Titulli:** Pastrues i Zyrave dhe Objekteve  
**Numri i ekzekutuesve:** 2  
**Orët e punës:** 40 orë në javë  
**Kohëzgjatja e emërimit:** Me kohë të caktuar një (1) vit nga të cilat gjashtë (6) muaj do të jenë punë provuese, me mundësi vazhdimi.  
**Përgatitja profesionale:** Shkolla fillore  
**Përvoja e punës:** Nuk kërkohet përvojë pune  
**I raporton:** Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve  
**Koeficienti i pagës:** 434.78 Euro Bruto

#### Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

- Do të bëjë pastrimin e zyrave dhe objekteve varësisht nga marrëveshjet që ka punëdhënësi me palët e treta;
- Do të bëjë ruajtjen e mjeteve të punës të cilat përdoren për pastrim;
- Do të pastrojë të gjitha hapësirat për të cilat udhëzohet nga eprori;
- Do të ndjekë rregullat e higjienës dhe rregullat e sigurisë sipas udhëzimeve të eprorit si dhe përgjegjësitë e tjera të cilat ndërlidhen me vendin e punës dhe në bazë të kërkesës së eprorit;
- Kryejnë punë tjera në bazë të urdhrave nga menaxhmenti i ndërmarrjes;
- Për punën që kryen i përgjigjet Udhëheqësit të Njesisë së Mirëmbajtjes - Pastrimit të Zyrave dhe Objekteve;

#### Aplikacionit i duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i N.P.L. "Përparimi" Sh. A - Vushtri. (E skanuar);
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e skanuar);
- Ekstraktin e lindjes; (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Certifikatën mbi dënimin penal të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohet);
- Dëshmitë për përvojën e punës (të skanuara) (nuk është obligative);
- Kopjen e letërnjoftimit (e skanuar);

#### ➤ Kriteret e përgjithshme që duhet t'i plotësojnë të gjithë kandidatët.

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë veprimi.
- Të zotërojë të paktën njëherë nga gjuhët zyrtare në pajtim me Ligjin për Gjuhët.

#### ➤ Mënyra e vlerësimit të kandidatëve.

- Testimi me shkrim deri në shtatëdhjetë (70) pikë.
- Intervista me gojë deri në njëzetë (20) pikë
- Jetë përshkrimi (CV) i kandidatit deri në dhjetë (10) pikë.

#### ➤ Dokumentet që kërkohet para themelimit të marrëdhënies së punës:

- Vërtetimi për zotësinë e plotë të veprimit.
- Certifikatën shëndetësore.

#### ➤ Periudha e aplikimit të kandidatëve dhe kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit.

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga dita e publikimit të të njëjtit. Shpallja është e hapur nga data 19.05.2026 deri me datë 03.06.2026 ora 16:00.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Verifikimi paraprak i aplikacioneve të kandidatëve më së largu deri me datë 10.06.2026.
- Afati për ankesë kundër njoftimeve për verifikimin paraprak të kandidatëve nga data 11.06.2026 deri me datë 15.06.2026.
- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 22.06.2026.
- Afati për ankesë ndaj njoftimeve për rezultatet e testit me shkrim nga data 23.06.2026 deri me datë 25.06.2026.

- Periudha e kandidatëve kur do t'i nënshtrohen intervistës me gojë, dhe kur do të bëhet vlerësimi i tyre do të jetë më së largu deri me datë 30.06.2026.
- Afati për ankesë nga data 01.07.2026 deri me datë 03.07.2026.
- Publikimi i rezultateve përfundimtare në lidhje me kandidatin e suksesshëm është më së largu 16.07.2026.

Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, varësisht nga ajo se a është parashtruar ankesë apo jo, dhe varësisht nga puna e komisionit vlerësues, dhe departamentit të personelit. Në të gjitha rastet kur parashtrohet ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, derisa e njëjta të shqyrtohet nga Komisioni i Ankesave.

#### ➤ Mënyra e aplikimit dhe komunikimi me kandidatët

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në Zyrën e Arkivës të N.P.L. "Përparimi" Sh. A në qytetin e Vushtrrisë, rr. "Gjergj Kastrioti Skënderbeu" nr. 82, (ish objekti i TMK-së afër Gjykatës Themelore Mitrovicë - dega në Vushtri) çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Departamenti i Personelit duke zbatuar nenin 8 par. 3 të Udhëzimit MFPT-Nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, do tu ofrojë sqarime të nevojshme për kandidatët në lidhje me kriteret e konkursit publik, dhe do tu asistoj dhe tu jap udhëzimet e nevojshme për aplikim me anë të adresës elektronike.

**Dorëzimi i aplikacionit me gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: [hrperparimi@gmail.com](mailto:hrperparimi@gmail.com).**

I gjithë komunikimi gjatë procedurave të konkursit publik do të zhvillohet nëpërmjet komunikimit elektronik, dhe secili nga kandidatët do të njoftohet individualisht.

Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen.

#### ➤ Sqarim

Ndërmarrja ka për qëllim të sqarojë çështjen e termeve të përdorura në aspektin gjinor, meqë rast fjalët dhe titujt e një gjinie përfshijnë edhe gjininë tjetër.

#### ➤ Përfundim

N.P.L. "Përparimi" Sh. A në Vushtri ofron mundësi të barabarta punësimi për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe inkurajohen komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuara, dhe gjinia më pak e përfaqësuar që të aplikojnë.

## NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Maholly" SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812321602 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Maholly" D.O.O. Mitrovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812321602 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Maholly" L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812321602 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



U prilog članu 8, članu 10 pod st. 2.2 i člana 15 Zakona br. 03/L-212 o radu objavljen u Službenom listu Republike Kosovo 01.12.2010, u vezi sa članom 7 Administrativnog uputstva MFPT - br. 01/2024 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, koji je deo Zakona br. 03/L-212 o radu koji je objavljen u Službenom listu Republike Kosovo dana 31.10.2017. godine, člana 18 i člana 22 Pravilnika br. 13/25 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mjesta, donijetog od strane Upravnog odbora N.P.L. "Përparimi" Sh. A a na osnovu rješenja br. protokola 1168/26 od 19.05.2026 godine glavnog izvršnog direktora, N.P.L. „Përparimi“ Sh. A od 19.05.2026, saopštava:

#### JAVNI KONKURS

- I. Naslov:** Čistač kancelarija i objekata  
**Broj izvršilaca:** 2  
**Radno vrijeme:** 40 sati sedmično  
**Trajanje termina:** Na određeno vreme od jedne (1) godine, od čega će šest (6) meseci biti probni rad, sa mogućnošću produženja  
**Stručna priprema:** Osnovna škola  
**radno iskustvo:** Nije potrebno radno iskustvo  
**Izveštava:** Rukovodioci Jedinice za održavanje - Čišćenje kancelarija i objekata  
**Koeficijent plate:** 434.78 Euro Bruto

#### Opis radnih obaveza i odgovornosti:

- Čistiće kancelarije i objekte u zavisnosti od ugovora koje poslodavac ima sa trećim licima;
- Čuvaće radni alat koji se koristi za čišćenje;
- Očistiće sve prostore za koje je upućen od nadređenog;
- Pridržavaće se pravila higijene i bezbednosti prema uputstvima pretpostavljenog kao i drugih obaveza u vezi sa radnim mestom a na osnovu zahteva pretpostavljenog;
- Obavlja druge poslove na osnovu naloga rukovodstva preduzeća;
- Za poslove koje obavlja odgovoran je rukovodiocu Jedinice za održavanje – čišćenje kancelarija i objekata;

#### Uz prijavu je potrebno priložiti sljedeće:

- Prijavni obrazac za NPL "Përparimi" Sh. A - Vuçitrm. (skenirano);
- Potvrde o školskoj spremi (skenirane);
- Ekstrakt rođenja; (sertifikat izdat online na platformi e-Kosova će biti prihvaćen);
- Potvrda o krivičnoj osudi koju je izdao Sudski savet Kosova, da nema krivičnih osuda u centralnoj krivičnoj evidenciji Republike Kosovo (uverenje izdato online na platformi e-Kosova će biti prihvaćeno);
- Dokaz o radnom iskustvu (skenirano) (nije obavezno);
- Kopija lične karte (skenirana);

#### Opšti kriterijumi koje svi kandidati moraju ispuniti

- Budite državljanin Republike Kosovo.
- Imaju puni kapacitet za djelovanje.
- Da vlada najmanje jednim od službenih jezika u skladu sa Zakonom o jezicima.

#### Način vrednovanja kandidata.

- Pismeni test do sedamdeset (70) bodova.
- Usmeni intervju do dvadeset (20) bodova
- CV kandidata do deset (10) bodova.

#### Dokumenti koji se zahtevaju pre zasnivanja radnog odnosa:

- Uverenje o punoj poslovnoj sposobnosti.
- Lekarsko uverenje.

#### Rok za prijavu kandidata i okvirni kalendar procedure zapošljavanja.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) kalendarskih dana od dana njegovog objavljivanja. Oglas je otvoren od 19.05.2026 godine do 03.06.2026 godine u 16:00 časova.

#### Okvirni kalendar procedure regrutovanja:

- Preliminarna verifikacija aplikacija kandidata najkasnije do 10.06.2026 godine.
- Rok za žalbu protiv obaveštenja o preliminarnoj verifikaciji kandidata od 11.06.2026 do 15.06.2026 godine.
- Period kada će kandidati pristupiti pismenom testu, i kada će se izvršiti njihovo ocenjivanje biće najkasnije do 22.06.2026 godine.
- Rok za žalbu na obaveštenja o rezultatima pismenog testa od 23.06.2026 do 25.06.2026 godine.
- Period kada će kandidati pristupiti usmenom intervjuu, i kada će se izvršiti njihovo ocenjivanje biće najkasnije do 30.06.2026 godine.
- Rok za žalbu od 01.07.2026 do 03.07.2026 godine.
- Objavljivanje konačnih rezultata u vezi sa uspešnim kandidatom je najkasnije 16.07.2026 godine.

Okvirni kalendar postupka zapošljavanja može biti duži ili kraći, u zavisnosti od toga da li je pritužba podneta ili ne, a u zavisnosti od rada komisije za evaluaciju i kadrovske službe. U svim slučajevima kada se žalba podnese u bilo kojoj fazi postupka zapošljavanja, pritužba će imati suspenzivno dejstvo, sve dok istu ne razmotri Komisija za žalbe.

#### Kako se prijaviti i komunicirati sa kandidatima

Zainteresovani kandidati mogu dobiti prijavni formular u Arhivu NPL "Përparimi" Sh. A u gradu Vuçitrmu, ul. "Gjergj Kastriot Skënderbeu" br. 82, (bivša zgrada TMK kod Osnovnog suda u Mitrovici – ogranak u Vuçitrmu) svakog radnog dana od 08:00 do 16:00 časova. Kadrovska služba za sprovođenje člana 8 st. 3 Uputstva MFPT-br. 01/2024 za Uređenje konkursnih procedura u javnom sektoru, daće potrebna pojašnjenja za kandidate u vezi sa kriterijumima javnog konkursa, te pomoći i dati potrebna uputstva za prijavu putem elektronske adrese.

Podnošenje prijave sa svom dokumentacijom traženom u ovom javnom oglasu vrši se isključivo putem elektronske adrese i to: [hrperparimi@gmail.com](mailto:hrperparimi@gmail.com).

Sva komunikacija u toku postupka javnog nadmetanja odvijaje se putem elektronske komunikacije, a svaki od kandidata će biti pojedinačno obaviješten.

**Napomena: Prijave dostavljene nakon navedenog roka neće biti prihvaćene.**

#### Objašnjenje

Preduzeće ima za cilj da pojasni pitanje termina koji se koriste u rodnom aspektu, pri čemu reči i titule jednog roda uključuju i drugi rod.

#### ZAKLJUČAK

NPL "Përparimi" Sh. A u Vuçitrmu nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo, a najvećinske zajednice i njihovi pripadnici, osobe sa invaliditetom i nedovoljno zastupljeni pol se podstiču da se prijave.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Teki Muhadri nga Demjan shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme teknike "Nexhmedin Nixha" Auto Elektracist Gjakovë.
- Arbenita Isufi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Teki Muhadri nga Demjani shpall të pavlefshme diplomën e dhe certifikatën bukëpjekës të lëshuar nga Sh. M Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Sabit Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Institucionit të Arsimit dhe Aftësimit Profesional "Fehmi Agani" Klinë.
- Agron Azemi shpall të pavlefshme dëftesat diplomën dhe certifikatën e testit të maturës të sh.m.l.m "Dr. Xheladin Deda" Mitrovicë.
- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U "Engjëll Gjoni", Novosellë, nga klasa 1-8.
- Florian Racaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Musa Hoti" ish shkolla fillore "Meto Bajraktari".
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.
- Kadri Sadiku shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni" ish shkolla fillore "25 Maji" .
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit "Fehmi Agani" Baçelor i Edukimit Fillor.
- Market Berisha SH.P.K shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 810186248.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. "Selman Riza" Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Milaim Peci B.I shpall te pavlefshme certifikatën e TVSH-së me numër: 330537334.
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Lavdie Kukaj shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Migjeni"- Bance Drenas.
- Luan Matoshi shpall të pavlefshme dëftesat e kl.1.2.3.4 dhe diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.  
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.a.  
e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)  
www: [pallatirinise.com](http://pallatirinise.com)

Nr. 11066 Dt 19.05.2026

Në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në bazë të nenit 12 të Rregullores së marrëdhënies së punës nr. 1/1338 datë 14.11.2024, në bazë të Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës nr. 1/1373, datë 22.11.2024 dhe plotësimit ndryshimi 1/2017 data 28.10.2025 pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, me datën : 19.05.2026, merr këtë:

### KONKURS PUBLIK Për plotësimin e vendit të lirë të punës

#### I. Titulli i vendit të punës: Arkatari (një vend pune);

#### II. Lartësimin e pagës mujore për vendin e punës:

- Paga bazë bruto është 556,87 EURO, e cila rrjedh nga një koeficient prej 2.33, me vlerë monetare të koeficientit 239,00 €.
- I/E punësuar përfiton edhe shtesë për përvojë pune, e cila llogaritet në masën 0.5% për çdo vit të përvojës së plotë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përfiton gjithashtu shtesën për shujtë të ngrohtë, sipas politikave të ndërmarrjes.

#### III. Përmbledhje e shkurtër të përshkrimit të punës, në të cilin përshkruhet qëllimi i vendit të punës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Udhëheqë komplet punët e arkës në përputhje me rregulloren dhe ligjin e punës së arkës,
- Sipas urdhrat dhe nënshkrimit të çekut nga çertifikuesi i pagesave, arkatari bënë realizimin e pagesave për nevojat të ndryshme.
- Është i detyruar që për çdo ditë të udhëheqë raportin e arkës në dy kopje ku origjinali duhet të dërgohet në kontabilitet,
- Kryen edhe punë tjera në kuadër të punëve dhe detyrave të punës sipas urdhërësës së Përgjegjësit të Financave.
- Pranon shumën e caktuar të mjeteve financiare në baza mujore, nga personi i autorizuar.

#### IV. Kriteret e përgjithshme dhe të vecanta për vendin e punës:

- Kualiteti i mesëm-drejtimit ekonomik;
- Përvojë një vjeçare në profesion;
- Numri i nevojshëm të kryerësit të punës është vetëm një (1) person.

#### V. Specifikimi i dokumenteve/dëshmiave përkatëse për vërtetimin e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të vendit të punës:

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikimit);
- Kopje e letërnjoftimit; CV; Certifikata e lindjes. Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin fillor të noterizuar;
- Diploma nga shkollimi fillor i huaj duhet të jenë të nostrifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë pozitë;
- Pasqyrat e kontributeve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësi nuk kanë qenë të detyruar të pagujnë në këtë institucion);

- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (njeshhtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

#### VI. Informata nëse emërimi është me afat të caktuar apo të pacaktuar, dhe kohëzgjatja e periudhës provuese:

- Lloji i kontratës: Kontratë në kohë të caktuar për periudhë prej gjashtë (6) muajsh, me mundësi vazhdimi.
- Periudha provuese: 6 muaj, gjatë të cilëve, punëdhënësi dhe i punësuar mund të ndërpresin marrëdhënien e punës me njoftim paraprak prej 7 ditësh.

#### VII. Datën dhe orën e saktë të përmbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur nga data 19.05.2026 deri me datën 02.06.2026.

#### VIII. Mënyra e aplikimit në konkurs:

- Dokumentet e kërkuara: Të gjithë kandidatët duhet të skanojnë të gjitha dokumentet që kërkohen sipas pikës V dhe t'i dërgojnë ato, së bashku me kërkesën për punësim/aplikacionin, në adresën e-mailit: [burimetnjerzore@pallatirinise.com](mailto:burimetnjerzore@pallatirinise.com).
- Kthimi i informacionit: Njësia e Burimeve Njerëzore do të sigurojë informacion për pranimin e kërkesave për punësim/aplikacioneve.
- Sqarime të tjera: Njësia e burimeve njerëzore e institucionit publik ofron sqarime të nevojshme për kandidatët lidhur me kriteret e konkursit publik gjatë fazës së aplikimeve.

#### IX. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

- Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistim (testim me gojë).
- Kalueshmëria është arritja e së paku 55 pikëve nga të gjitha fazat e konkursit.

#### X. Kalendar i procedurës së rekrutimit:

- Pas mbylljes së afatit të konkursit, njësia e burimeve njerëzore do të verifikojë aplikimet brenda 7 ditëve dhe do të konfirmojë përmbushjen e kriterëve nga kandidatët.

#### XI. Shënimi për aplikacionet e dërguara pas afatit:

Aplikacionet e dërguara pas datës 02.06.2026 nuk do të shqyrtohen



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.  
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.a.  
e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)  
www: [pallatirinise.com](http://pallatirinise.com)

Nr. \_\_\_\_\_ Dt \_\_\_\_\_

U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212, na osnovu člana 5. Administrativnog uputstva MFPT br. 01/2024 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, na osnovu člana 12. Uredbe o radnim odnosima br. 1/1338 od 14.11.2024. godine, na osnovu Uredbe o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1/1373 od 22.11.2024. godine i Izmene br. 1/2017 od 28.10.2025. godine, nakon pregleda zalteva i dostavljene dokumentacije, Generalni direktor N.P.L. PALATI I RINISE J.A. u Prištini, dana: 19.05.2026. godine, prima sledeće:

### JAVNI KONKURS Za popunjavanje upraznjenog mesta

#### I. Naziv posla:

Blagajnik (jedno radno mesto);

#### II. Mesečna plata za radno mesto;

- Bruto osnovna plata je 556,87 € URO, što je izvedeno iz koeficijenta 2,33, sa novčanom vrednošću koeficijenta 239,00 €.
- Zaposleni takođe ima koristi od bonusa za radno iskustvo, koji se obračunava po stopi od 0,5% za svaku godinu punog radnog iskustva, u skladu sa važećim zakonskim propisima. On/ona takođe ima koristi od bonusa za topli obrok, u skladu sa politikama kompanije.

#### III. Kratak rezime opisa posla, koji opisuje svrhu posla, kao i glavne dužnosti i odgovornosti; Dužnosti i odgovornosti

- Upravlja poslovanjem blagajne u skladu sa propisima i zakonima o blagajni,
- Prema nalogu i potpisu čeka overivača plaćanja, blagajnik vrši plaćanja za različite potrebe.
- Obavezan je da svakodnevno vodi izveštaj blagajne u dva primerka, pri čemu original mora biti poslat u računovodstvo,
- Obavlja i druge poslove u okviru posla i radnih obaveza po nalogu menadžera finansija.
- Prima određeni iznos finansijskih sredstava na mesečnom nivou, od ovlašćenog lica.

#### IV. Opšti i specifični kriterijumi za posao;

- Srednja kvalifikacija - ekonomski menadžment;
- Jedna godina iskustva u struci;
- Potreban broj radnika je samo jedna (1) osoba.

#### V. Specifikacija relevantnih dokumenata/dokaza kojima se dokazuje ispunjavanje opštih i specifičnih kriterijuma za posao;

- Kandidati zainteresovani za ovaj posao moraju priložiti sledeća dokumenta:
- Obrazac za prijavu za posao;
- Kopiju lične karte; CV; Izvod iz matične knjige rođenih. Motivaciono pismo;
- Overeni dokaz o obrazovanju i stručnoj kvalifikaciji;
- Diplome sa stranih univerziteta moraju biti notarizovane od strane Ministarstva prosvete, nauke i tehnologije i overene.
- Dokaz o radnom iskustvu/potvrda izdata od strane nadležne institucije za zapošljavanje o radnom iskustvu, sa navođenjem radnog mesta i trajanja angažovanja na tom mestu;
- Izjave o penzijskim doprinosima (nisu potrebne za radna iskustva pre osnivanja Kosovskog penzionog fonda, kao i za ona iskustva kada poslodavci nisu bili obavezni da uplaćuju u ovu instituciju);
- Potvrda nadležnog suda da se ne vodi krivični postupak i da lice nije osuđivano za bilo koje krivično delo (ne starije od 6 (šest) meseci od datuma izdavanja);
- Spisak dostavljenih dokumenata.
- Kada dođe do sporova, oštećenja robe, prekomernih ili nedovoljnih isporuka, neizvršenja ili drugih relevantnih komplikacija, čuva sve relevantne komunikacije i primljene dokaze, na osnovu Pravila i Operativnih smernica za javne nabavke;
- Prati izveštaje rukovođilaca ugovora, prati izvodače radova koji nisu ispunili svoje ugovorne obaveze, u vezi sa odgovarajućom nadoknadom, likvidacijom štete i dogovorom o raskidu ugovora;
- Izveštava godišnje na kraju svake fiskalne godine za potpisane ugovore;
- Priprema nedeljne i mesečne izveštaje sa Izvršnom komisijom;
- Obavlja i druge poslove vezane za opis posla, kao i poslove koje mu dodeli Izvršna komisija.

#### VI. Informacije o tome da li je imenovanje na određeno ili neodređeno vreme i trajanje probnog perioda:

- Vrsta ugovora: Ugovor na određeno vreme u trajanju od šest (6) meseci, sa mogućnošću produženja.
- Probni period: 6 meseci, tokom kojeg poslodavac i zaposleni mogu prekinuti radni odnos uz prethodno obaveštenje od 7 dana.

#### VII. Tačan datum i vreme zatvaranja konkursa:

- Konkurs je otvoren od 19.05.2026 do 02.06.2026

#### VIII. Kako se prijaviti na konkurs:

- Potrebna dokumenta: Svi kandidati moraju skenirati sva dokumenta potrebna pod tačkom V i poslati ih, zajedno sa zahtevom/prijavom za zaposlenje, na imejl adresu: [burimetnjerzore@pallatirinise.com](mailto:burimetnjerzore@pallatirinise.com).
- Povraćaj informacija: Jedinica za ljudske resurse će pružiti informacije o prijemu zahteva/prijava za zaposlenje.
- Ostala pojašnjenja: Jedinica za ljudske resurse javne ustanove pruža potrebna pojašnjenja kandidatima u vezi sa kriterijumima javnog konkursa tokom faze prijave.

#### IX. Način evaluacije i kriterijumi bodovanja:

- Procena kandidata će se vršiti putem pismenog testa i intervjuja (usmeni test).
- Polaganje je postizanje najmanje 55 poena iz svih faza konkursa.

#### X. Kalendar postupka zapošljavanja:

- Nakon završetka roka za konkurs, jedinica za ljudske resurse će proveriti prijave u roku od 7 dana i potvrditi da kandidati ispunjavaju kriterijume.

#### XI. Napomena o prijavama podnetim nakon roka:

- Prijave podnete nakon 02.06.2026 neće biti razmatrane.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.  
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.  
e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)  
www: [pallatirinise.com](http://pallatirinise.com)

Nr. 11047 Dt 19.05.2026

Në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ MFPT nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, në bazë të nenit 12 të Rregullores së marrëdhënies së punës nr. 1/1338 datë 14.11.2024, në bazë të Rregullores mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës nr. 1/1373, datë 22.11.2024 dhe plotësim ndryshimi 1/2017 data 28.10.2025 pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit të paraqitur, Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, me datën : 19.05.2026, merr këtë:

### KONKURS PUBLIK Për plotësimin e vendit të lirë të punës

#### I. Titulli i vendit të punës: Faturist/e (një vend pune);

#### II. Lartësimin e pagës mujore për vendin e punës:

- Paga bazë bruto është 549,70 EURO, e cila rrjedh nga një koeficient prej 2.3, me vlerë monetare të koeficientit 239,00 E.
- I/E punësuar përfiton edhe shtesë për përvojë pune, e cila llogaritet në masën 0.5% për çdo vit të përvojës së plotë në punë, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përfiton gjithashtu shtesën për shujtë të ngrohtë, sipas politikave të ndërmarrjes.

#### III. Përmbledhje e shkurtër të përshkrimit të punës, në të cilin përshkruhet qëllimi i vendit të punës, si dhe detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

##### Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Përgatit dhe lëshon fatura për shërbime dhe produkte të ofruara nga kompania.
- Regjistron të gjitha transaksionet e shitjeve dhe blerjeve në sistemin kontabël.
- Kontrollon dhe siguron saktësinë e të gjitha faturave të lëshuara dhe të pranuar.
- Menaxhon dhe mirëmban dokumentacionin përkatës të faturave, duke siguruar që të gjitha të dhënat të jenë të plota dhe të sakta.
- Përcjell dhe verifikon statusin e pagesave nga klientët dhe furnitorët, duke ndjekur pagesat e vonuara dhe duke raportuar për detyrimet e papaguara.
- Përgatit raporte mujore dhe vjetore për faturimet dhe pagesat, sipas kërkesës së menaxhmentit.
- Siguron që të gjitha faturat dhe dokumentet financiare të jenë në përputhje me politikën e kompanisë dhe rregulloret ligjore.
- Ndihmon në procesin e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe raporteve kontabël.
- Përcjell statusin e stokut dhe ndihmon në përgatitjen e urdhrave të blerjes bazuar në nevojat e kompanisë.
- Komunikon me klientët dhe furnitorët për çështje të lidhura me faturimet dhe pagesat.
- Ndihmon në procesin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, duke siguruar dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm.
- Kryen punë dhe detyra të tjera të lidhura me përshkrimin e detyrave të punës, të cilat kerkohen nga udhëheqësi.

#### IV. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për vendin e punës:

- Diplomë e shkollës së mesme (preferohet shkolla e mesme ekonomike).
- Minimumi 1 vit përvojë pune në pozita të ngjashme.
- Afërsi të shkelqyera organizative dhe menaxhimit të kohës.
- Vëmendje e fortë ndaj detajeve dhe saktësisë.
- Afërsi të mira komunikimi dhe ndërveprimi me klientët dhe furnitorët.
- Afërsi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në ekip.
- Njohuri të mira të ligjeve dhe rregulloreve financiare dhe kontabël.

#### V. Specifikimi i dokumenteve/dëshmiave përkatëse për vërtetimin e përmbushjes së kriteve të përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës:

- Kandidatët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjasin këto dokumente:
- Formulari i kërkesës për punësim (aplikim);
- Kopje e letrënjohimit; CV; Certifikata e lindjes, Letër motivimi;
- Dëshmitë mbi Shkollimin dhe kualifikimin fillor të noterizuar;
- Diploma nga shkollimi fillor i huaj duhet të jenë të noterifikuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe e noterizuar.
- Dëshmi për përvojën e punës/vërtetim i lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimeve në atë poziti;
- Pasqyrat e kontributëve pensionale (nuk kërkohet për përvojat e punës para themelimit të Fondit të Kurimeve Pensionale të Kosovës, dhe për ato përvoja kur punëdhënësi nuk kanë qenë të detyruar të pagujnë në këtë institucion);
- Certifikatë nga gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale dhe që nuk është i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale (jo më e vjetër se 6 (gjashtë) muaj nga data e lëshimit);
- Lista e dokumenteve të dorëzuara.

#### VI. Informata nëse emërimi është me afat të caktuar apo të pacaktuar, dhe kohëzgjatja e periudhës provuese:

- Lloji i kontratës: Kontratë në kohë të caktuar për periudhë prej gjashtë (6) muajsh, me mundësi vazhdimi.
- Periudha provuese: 6 muaj, gjatë të cilëve, punëdhënësi dhe i punësuar mund të ndërpresin marrëdhënien e punës me njoftim paraprak prej 7 ditësh.

#### VII. Datën dhe orën e saktë të përmbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur nga data 19.05.2026 deri me datën 02.06.2026.

#### VIII. Mënyra e aplikimit në konkurs:

- Dokumentet e kërkuara: Të gjithë kandidatët duhet të skanojnë të gjitha dokumentet që kërkohen sipas pikës V dhe t'i dërgojnë ato, së bashku me kërkesën për punësim/aplikacionin, në adresën e-mailit: [burimetnjerzore@pallatirinise.com](mailto:burimetnjerzore@pallatirinise.com)
- Kthimi i informacionit: Njësia e Burimeve Njerzore do të sigurojë informacion për pranimin e kërkesave për punësim/aplikacione.
- Sqarime të tjera: Njësia e burimeve njerzore e institucionit publik ofron sqarime të nevojshme për kandidatët lidhur me kriteret e konkursit publik gjatë fazës së aplikimeve.

#### IX. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit:

- Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistim (testim me gojë).
- Kalueshmëria është arritja e së paku 55 pikëve nga të gjitha fazat e konkursit.

#### X. Kalendar i procedurës së rekrutimit:

- Pas mbylljes së afatit të konkursit, njësia e burimeve njerzore do të verifikojë aplikimet brenda 7 ditëve dhe do të konfirmojë përbushjen e kriteve nga kandidatët.

#### XI. Shënimi për aplikacionet e dërguara pas afatit:

- Aplikacionet e dërguara pas datës 02.06.2026 nuk do të shqyrtohen.



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.  
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.  
e-mail: [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)  
www: [pallatirinise.com](http://pallatirinise.com)

Nr. \_\_\_\_\_ Dt \_\_\_\_\_

U skladu sa članom 8. Zakona o radu br. 03/L-212, na osnovu člana 5. Administrativnog uputstva MFPT br. 01/2024 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, na osnovu člana 12. Uredbe o radnim odnosima br. 1/1338 od 14.11.2024. godine, na osnovu Uredbe o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1/1373 od 22.11.2024. godine i Izmene br. 1/2017 od 28.10.2025. godine, nakon pregleda zahteva i dostavljene dokumentacije, Generalni direktor N.P.L. PALLATI I RINISE J.A. u Pristini, dana: 19.05.2026. godine, prima sledeće:

### JAVNI KONKURS Za popunjavanje ipraznjenog mesta

#### I. Naziv radnog mesta: Fakturator (jedan posao);

#### II. Mesečna plata za radno mesto:

- Bruto osnovna plata iznosi 549,70E, što je izvedeno iz koeficijenta 2.33, sa novčanom vrednošću koeficijenta od 239,00 E.
- Zaposleni takođe ima koristi od bonusa za radno iskustvo, koji se obračunava po stopi od 0.5% za svaku godinu punog radnog iskustva, u skladu sa važećim zakonskim propisima. Takođe ima koristi od bonusa za topli obrok, u skladu sa politikama kompanije.

#### III. Kratak rezime opisa posla koji opisuje svrhu posla, kao i glavne dužnosti i odgovornosti:

- Priprema i izdaje fakture za usluge i proizvode koje pruža kompanija.
- Evidentira sve prodajne i kupovne transakcije u računovodstvenom sistemu.
- Proverava i osigurava tačnost svih izdatih i primljenih fakturna.
- Upravlja i održava relevantnu dokumentaciju o fakturama, osiguravajući da su svi podaci potpuni i tačni.
- Prati i verifikuje status plaćanja od kupaca i dobavljača, preteći kašnjenja u plaćanjima i izveštavajući o neplaćenim obavezama.
- Priprema mesečne i godišnje izveštaje o naplati i plaćanjima, na zahtev menadžmenta.
- Osigurava da su sve fakture i finansijska dokumenta u skladu sa politikama kompanije i zakonskim propisima.
- Pomaže u procesu pripreme finansijskih izveštaja i računovodstvenih izveštaja.
- Prati stanje zaliha i pomaže u pripremi porudžbenica na osnovu potreba kompanije.
- Komunicira sa klijentima i dobavljačima o pitanjima vezanim za fakturisanje i plaćanja.
- Pomaže u procesu interne i eksterne revizije, pružajući potrebnu dokumentaciju i informacije.
- Obavlja i druge poslove i dužnosti vezane za opis posla, koje zahteva menadžer.

#### IV. Opšti i specifični zahtevi za posao:

- Diploma srednje škole (poželjno srednja ekonomska škola).
- Minimum 1 godina radnog iskustva na sličnim pozicijama.
- Osnovno znanje računovodstva i finansija.
- Dobro poznavanje rada na računaru, posebno u Microsoft Office-u i finansijskim programima.
- Odlučne organizacione veštine i veštine upravljanja vremenom.
- Snažna pažnja posvećena detaljima i tačnosti.
- Dobre komunikacione veštine i interakcija sa kupcima i dobavljačima.
